

# KOSOVARIA

Ballina: Arbnora Ademaj  
Foto: Jeton Bylykbashi  
Styling: Kujta & Meri  
Makeup: Sellma & Kaci

JETA E  
ARBнора  
ADEMAJT  
NË TREKËNDËSHIN  
STAMBOLL-KOSOVË-TIRANË

GËZUAR  
2024



DINO  
QERAMIKA



*Gëzuar*

FESTAT E FUNDVITIT

— DHE —

URIME VITIN E RI 2024



*Arbnora Ademaj ka jetuar një vit me shumë punë, angazhime, udhëtime dhe sukse.*

*Viti 2023 ishte brilant, si vetë ajo.*

*Ylli i kinematografisë turke, imazhi i numrit festiv të "Kosovares", ndanë me lexuesit rrjedhën e 12 muajve të saj...*

*Përtej sharmit të pakrahasueshëm, shkëlqimit në ekran, fotove të mrekulueshme në "Instagram", Arbnora Ademaj nuk ndalet së punuari dhe bën jetë aktive profesionale ndërmjet Stambollit, Kosovës dhe Tiranës.*

*Pra, jeta e saj është e lidhur ngushtë me këtë trekëndësh.*

# Jeta e Arbnora Ademajt në trekëndëshin Stamboll-Kosovë-Tiranë



## JANAR

- Janari i vitit 2023 ishte thuajse i tëri festë për mua, meqë, më në fund, kisha mundësi të qëndroja më shumë me familjen time.

Pas shumë angazhimesh ndër vite, më në fund, vendosa të qëndroja pak më gjatë pranë më të dashurve në Katund të Ri. Më kishte munguar jashtë mase familja dhe këtë kohë e kam shijuar maksimalisht pranë tyre. Do ta kujtoj si një muaj tejet të bukur...

## SHKURT

- Vazhdova me punë dhe angazhime në Turqi, filluan xhirimet e filmit që pritet të shfaqet së shpejti, meqë premiera e tij veç është bërë.

Ishte një muaj me shumë aktivitete, lodhje, por edhe atraksione.

## MARS

- Gjatë këtij muaji, më tepër isha e fokusuar tek biznesi "Allure Beauty" në Tiranë, ku bashkë me partneret e mija jemi munduar të sjellim trendet e fundit sa i përket estetikës.

Jam shumë e lumtur për suksesin e deritanishëm, të arritur bashkërisht.

## PRILL

- Kam vazhduar sërish në Stamboll, për përgatitjet e një filmi tjetër.

Muaj i bukur, me punë, takime dhe plane të reja... Më pëlqen prilli, meqë nuk është as shumë

ftohtë e as shumë nxehtë. E kam shijuar...

## MAJ

- Majin e kam kaluar sa në Kosovë e sa në Stamboll, me punë dhe dinamika pak a shumë të zakonshme.

Nuk ishte nga ata muaj që të ngulfasin me punë. Përgjithësisht, muaj i qetë dhe normal.

## QERSHOR

- Filloi puna e vërtetë me orë të zgjatura, me shumë sete xhirimesh në lokacione të ndryshme. Një përfshirje totale në punë, pa shumë kohë për gjëra të tjera, ndërkohë që i nxehti kishte marrë hov.

## KORRIK

- Në korrik vazhduan xhirimet e një filmi akcion-komedi në Brusë të Turqisë, me një produksion gjigant dhe me një kast aktorësh turq shumë të njohur.

Në këtë muaj kam përjetuar një nga eksperiencat e mija më të mira profesionale në Turqi. Jam shumë e lumtur që kam arritur të jem pjesë e një projekti dhe kasti aq të madh...

## GUSHT

- Gushti ishte muaj lëvizjesh e pushimesh ndërmjet Italisë, Gjermanisë dhe bregdetit shqiptar.

Sepse, njeriu ka nevojë edhe për pak pushim e relaksim...



## SHTATOR

- Isha kryesisht në Stamboll, duke u përgatitur për disa projekte të reja, gjithashtu në kontakt të vazhdueshëm me profesorë të aktrimit në Turqi, sepse, përveç xhirimeve, vazhdoj të ndjekë kurse aktrimi, meqë në çdo projekt dua të jem e shkëlqyeshme...

## TETOR

- Punë, punë, punë... Ndërkohë, mendjen e kisha edhe te një projekt i ri dhe interesant në Kosovë...

## NËNTOR

- Jam kthyer në Kosovë për një serial që do të realizohet. I kam munguar skenës sonë, andaj me dëshirë dua të jem pjesë e një projekti shqiptar.

## DHJETOR

- Muaji i energjisë së mirë, i një ndjenje të lehtësimit shpirtëror, pas një pune të gjatë e të suksesshme gjatë gjithë vitit. Isha e inkuadruar në projekte prestigjioze në Turqi, një ëndërr kjo e bërë realitet pas shumë mundimeve, sakrificave e vajtjeve. Puna e pandalshme shpërblehet dhe kjo është e sigurt... Në këtë muaj kam realizuar edhe setin e ri fotografik për Revistën "Kosovarja", revistë e cila më ka qëndruar pranë në çdo hap timin. Urime festa! Shëndet, begati e dashuri nga e juaja Arbnora!

**Nderim Neziri**



# IPA IDENI FI KUIAR

## Ngrohë shtëpinë me kunjja të varreve!

*Më ka rënë të dëgjoj e shoh shumëçka, ama pamje më të rëndë seç kam parë në Lagjen “Kodra e Trimave” në Prishtinë, të dielën që e lamë pas, nuk më ka rëndë të shoh...*

Teksa paradite kthehesha nga varrezat e Prishtinës, afër shtëpisë-shkollë të Herticëve, në Lagjen “Kodra e Trimave” në Prishtinë, një burrë rreth të 60-ave, ishte ulur ngaluc pranë një kolice, të cilën e kishte mbushur spicë me kunjja të varreve.

Edhe nga larg mund t’i lexosh emrat e të vdekurve, datat e lindjeve dhe të vdekjeve...

Në çast e ndala veturën. E shikova me keqardhje, me dhembje në shpirt... Ishte mëngjesi i parë i sivjetmë, e që temperatura veç zbriti në minus

2, e tymin e cigares që e thithte pa pushim, të ftohtit ia shpërndante përtokë.

Eh, thashë me vete, edhe këtë gjë e pashë me sytë e mi...

Kam qenë e ku nuk kam qenë në cilësinë e gazetarit: nga Prishtina në Oslo të Norvegjisë; nga Prishtina në Artë e Prevezë të Greqisë; nga Prishtina në Bafër e Samsun të Turqisë, atje ku pjesa dërmuese e popullatës janë shqiptarë, e që në Anadoll kam parë skamje e varfëri të paskajshme; nga Prishtina në Shqipërinë e vitit

1990, kohë kur çdo gjë ishte e shkatërruar, por skamjen e mjerimin më të madh e kemi ne, në Kosovë.

Sepse, a ka më skamje se ta kalosh dimrin me kunjja të varreve?!

E, sa herë që në shporet shti dru, shti kunjja me emra të njerëzve të vdekur, do trishtohen gruaja, fëmijët dhe të tjerët që jetojnë aty!

Nuk di si ta arsyetoj veprimin e tij, por edhe ai burrë, pa pasur një arsye të fortë, nuk do i kishte mbledhur kunjat e varreve e t’i dërgonte në shtëpi!

**Isa ILAZI**



# GËZUAR, PËR ÇKA?!



Fund dhjetori.  
Fund i një motmoti.  
Fund i vitit 2023.  
Ishte ky vit, varet për kë, ishte qysh ishte:  
I lehtë,  
i vështirë,  
i mirë,  
i keq,  
i mbrapshtë,  
i mbarë,  
i dhembshur,  
i lumtur...  
Megjithatë, i takon vitit që po ikën, i takon të djeshmes, të shkuarës, që s'kthehet më.  
Çdoherë, me këtë rast, në këso momentesh, në vigjilje të kremtes së Vitit të Ri, një kohë përpara shkruanim këso shkrime me pak fjalë, paksa më festiv, paksa më me mall, nostalgji, romantikë...  
U ktheheshim ditëve, muajve, momenteve që i përjetonim brenda vitit...  
Shkruanim për skamnorët se si do e presin këtë natë kremteje, pranë sofrës së tyre të thatë, me bukë e çaj, kurse të pasurit në ahengje e udhëtime, me tryeza plot, me muzikë, me sevda...  
Gëzuar – që edhe i varfri të ketë çka të hajë!

\*  
Fund dhjetori, para festës të këtij motmoti të ri. Prapë, edhe sivjet, me më shumë të varfër e me më shumë të pasur...  
Nuk dua një

fund dhjetori me drita, ndriçime të rrugëve, por një fund dhjetori me njerëz që ndriçojnë nga lumturia, jeta më e mirë...  
Gëzuar - për ditë më të mira në vitin që po hymë!

\*  
Ndoth të dashurohesh me errësirën kur të mungon drita!  
Të jetosh me ëndrrën kur s'të pëlqen realiteti!  
Të bashkohesh me dhimbjen kur nuk gjen gëzimin!  
Të flasësh me heshtjen kur nuk të vijnë fjalët!  
Të mësohesh me pritjen kur vonon ardhja!  
E, ti, i dorëzohesh durimit nëse e ke humbur shpresën...  
Gëzuar - që shpresa të bëhet realitet!

\*  
Të gjithë duan ta ndryshojnë botën, por askush nuk dëshiron ta ndryshojë veten!  
Shpeshherë më vjen dëshira të ikë larg, shumë larg, sa askush atje s'do më njoh, ku nuk mund të shoh fytyra miqësore me qëllime djallëzore, të jem i huaj mes të huajve...  
Pse?!

Sepse, tash, kur jetoj në ditë lirie, në Kosovën e lirë, në Kosovën e pavarur, çdo gjë shkon mbrapshtë...  
Gëzuar - për një jetë më të mirë!

**Gani DILI**

## KOSOVARJA

magazinë e pavarur  
për familje

[www.kosovarja.al](http://www.kosovarja.al)

**Pronar dhe botues:**

Gani DILI

**Redaktor përgjegjës:**

Isa ILAZI

**Menaxher:**

Driton DILI

**Redaksia:**

Safet Krivaça (reporter i lirë)  
Nderim Neziri (redaktor)  
Besiana Dili  
Drenushë Haredinaj  
Ardita Dili  
Edona Vllasaliu - Bajoku  
Xheneta Spahiu  
Denisa Oruqi

**Dizajni:**

Labinot Bërbotovci

**Adresa e redaksisë:**

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: [info@kosovarja-ks.com](mailto:info@kosovarja-ks.com)

**Marketing:**

Tel: +383 44 143 448;

Email: [marketing@kosovarja-ks.com](mailto:marketing@kosovarja-ks.com)

Në prag të 34-vjetorit të vrasjes...



Ylfete dhe Mentor Humolli

# Ylfete Humolli me vëllanë për lirinë e Kosovës

*Vitet 90 do të mbahen mend, veç të tjerash, edhe për demonstratat e mëdha kundër Serbisë. Në njërin nga to, më 1 shkurt 1990, mijëra të rinj e të reja dolën në demonstrata në kauzën tonë për liri, për të kërkuar lirinë për popullin tonë, demonstratë ku ra heroikisht Ylfete Humolli.*

Në atë rrugë ishte edhe heroina jonë, Ylfete Humolli, e cila në demonstratat e 1 shkurtit 1990, në lulen e rinisë, në fshatin Lupç të Podujevës, ra heroikisht, në moshën 16-vjeçare, duke kërkuar liri për popullin shqiptar. "Për atdhe pyetet vetëm shpirti", ishin fjalët e fundit të saj teksa doli për herë të fundit nga shtëpia.

Por, pak më tej, në Lupç, te livadhet, aty ku mijëra protestues me dy gishtërinj lart kërkonin liri e pavarësi, do të binte dëshmorja, vrasja e së cilës do të bënte jehonë të madhe brenda dhe jashtë vendit, meqë vrasja e saj u xhirua nga një ekip gazetarësh e kameramanësh nga Sarajeva, e cila edhe u bë dëshmia më e fortë e realitetit se çka po ndodhte në Kosovë.

E, dëshmitarët thonë se fjalët e vetme të saj para se të jepte shpirt ishin: "Ku është Mentori?"

Mentori ishte vëllai i saj, 13-vjeçar, e që, gjithashtu, po protestonte atë ditë.

## TËRË KOSOVA NË VARRIMIN E YLFETES HUMOLLIT...

Varrimi i Ylfetes ishte masiv dhe në të morën pjesë qindra mijëra shqiptarë, të cilët nderuan guximin, veprën dhe atdhedashurinë e saj, ku varrimi i saj



Ylfete Humolli





Pamje nga varrimi i Ylfete Humollit

edhe u bë një formë demonstratë tjetër, pasi njerëzit, duke ngritur dy gishtërinj, përcillnin amanetin e Ylfetes, për të kërkuar liri e barazi. Sidoqoftë, Ylfetja e Mentori ishin prototipi i një brezi që nuk pati kurrë fëmijëri, sepse ata u rritën me tymin e gazit lotsjellës. Dhe, nëntë vite më vonë, Mentori vesh uniformën e UÇK-së dhe në moshën 23-vjeçare bie heroikisht në Betejën e Kosharës, më 21 maj 1999, e që më vonë, të gjithë të rënë në Betejën e Kosharës, u shpallën heronj, e në mesin e tyre edhe Mentor Isa Humolli.

## A MJAFTON VETËM NJË BUQETË ME LULE?!

Andaj, duhet ta pyesim vetveten dhe t'i themi ndërgjegjes sonë se a mjafton që të shkohet tek varri i Ylfete Humollit vetëm me një buqetë me lule?!

A mjafton që vetëm me fjalë t'i

përshkruajmë heroizmin e Ylfetes dhe të Mentorit?!

E, do të ishte nder shumë i madh për familjen dhe qytetarët llapjanë dhe më gjerë, që institucionet përkatëse të Komunës së Podujevës,

të marrin iniciativë që t'i ngritët përmendorja dhe ta kthejmë në bronz në qytetin e Podujevës, heroinën tonë, Ylfete Humollin. Sidoqoftë, në fshatin Lupç, buzë lumit Llap, janë dy varre-lapidare, që përjetësojnë kujtimin për motrën dhe vëllanë, Ylfete dhe Mentor Humollin, të rënë për liri.

## RAPSODËT KËNDOJNË PËR YLFETE HUMOLLIN

Ylfete Humollit i janë kushtuar edhe këngë.

I kënduan dhe i këndojnë këngë Mahmut Ferati, Vëllezërit Duraku, e të tjerë.

E, më 21 maj 2019, Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dëshmoret Ylfete Humolli i ndau dekoratën "Hero i Kosovës".

Pikërisht, në njëzetvjetorin e rënies së vëllait, Mentorit, familja pranuan dekoratën "Hero i Kosovës", dedikuar dëshmoret Ylfete Humolli.



Pllaka përkujtimore për Ylfete dhe Mentor Humollin





Pamje e Junikut

## Jetë e mirë si në Junik...

*Një shekull pa vrasje në Junik. Në këtë vend policia vazhdimisht është në “pushim”, sepse vrasje nuk ka në këtë vendbanim, siç ndodh pothuajse çdo ditë në vendbanime të tjera të Kosovës.*

Përrashtuar luftërat në këtë vend, në 100 vitet e fundit, siç mbahet mend, në Junik nuk ka pasur asnjë vrasje. Qetësia që të krijohet nga pamja e tij piktoreske sapo të shkelësh në këtë komunë dhe siguria e lartë, mikpritja e ngrohtë e banorëve që haset në çdo vend, qoftë në dyqane, rrugë, kafiteri, bëjnë që ky vend të jetë mjaft i vizituar nga vizitorë të shumtë.

Ndryshe, Juniku pritet të jetë një komunë edhe më e zhvilluar në vitet

në vijim, aq më parë, kur tashmë është plani që rruga e asfaltuar të shkojë deri në Bjeshkët e Gjeravicës, projekt tashmë që është përkrahur edhe nga Bashkësia Ndërkombëtare.

E, në fund të shtatorit edhe nisi asfaltimi i kësaj rruge, saktësisht segmenti Gjocaj-Livadh i Madh.

Andaj, rruga e Gjeravicës shënon një

nga projektet më të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe rritjen e mirëqenies në Junik.

Përveç këtyre, Juniku ofron edhe shumë objekte të ndryshme të trashëgimisë kulturore, kulla qindravjeçare, mullinj të ndryshëm, por edhe restorante që të ofrojnë ushqime tradicionale shqiptare.



Asfaltimi i rrugës Junik-Gjeravicë





# Gëzuar Festat e Fundvitit

DHE URIME VITIN E RI  
2024

★★★★★  
**BREZOVICA**  
HOTEL & SPA



**Bekim Fehmiu:**

## *“Nëna ime nuk dëshiron të vdesë pa e parë Shqipërinë!”*

*Ç’thoshte aktori i famshëm, Bekim Fehmiu, për Kosovën, Titon dhe bisedat e tjera që i bëri me personalitetet e artit e kulturës gjatë takimeve më 1972 në Shqipëri?*

Bekim Fehmiu, aktori ynë me renome botërore, për herë të parë e vizitoi Shqipërinë në vitin 1972. Atje qëndroi tri javë.

Raporti i Sigurimit të Shtetit për Bekim Fehmiun shkruante:

1. Sa i përket qëndrimit të serbëve ndaj Kosovës, ai kish një urrejtje të madhe për gjithë trajtimin që u është bërë kosovarëve, burgosjen e të atit nga serbofilët etj.

2. Bekim Fehmiu tregoi mjaft raste të formave të ndryshme, provokime dhe vrasje në masë të familjeve të tëra kosovare nga serbët.

“Njerëzit e qeverisë, tha ai, lajmëronin se ata që duan të kthehen në Shqipëri, le të regjistrohen. Gjendeshin shumë njerëz patriotë dhe, njëkohësisht, naivë, që binin në këtë kurth. Familjet e regjistruara i merrnin veç e veç me kamion dhe ato zhdukeshin”.

3. Duhet pranuar se ai ushqen iluzion për Titon dhe reformat e tij të fundit, duke ia atribuar çdo të keqe a gabim lidhur me Kosovën Rankoviçit dhe pasuesve të tij. Nga përshtypjet e këtyre ditëve, deri diku mund të mendohet se po të ketë një informim më të mirë, është i prirë që të kuptojë drejt

kontradiktat ideologjike.

4. Në biseda të ndryshme, në rreth shumë të ngushtë njerëzish, Bekimi tha: “Sigurisht, gjithë këto gjana nuk mund të jenë ba pa dorën e tij (Titos)! Dihet se “peshku qelbet nga koka”!

5. I dëshiruar për emrin e mirë të Shqipërisë në të gjithë botën, mendon se ne duhet të çajmë me filmat dhe artin tonë në Evropë. Për këtë ai u shpreh: “Evropa do të dijë për Shqipërinë, prandaj duhet të çani me guxim me filmat tuaj. Mendimi se filmat tuaj janë të mirë nuk është vetëm imi, por edhe i kolegëve të tjerë”.

6. Gëzohej kur shikonte në muzetë tanë që pasqyrohej lufta dhe historiku i Kosovës, por mendonte: “Dhe, ky nuk është vetëm mendim imi, thoshte - që duhet t’i jepet



më tepër vend propagandimit të historisë dhe kulturës së Kosovës, sepse kjo do na gëzonte së tepërmi”.

7. Nga ana tjetër, çmonte kujdesin tonë për të ruajtur Kosovën dhe kosovarët, kujdesin për të mos i dhënë shkas shpërthimit të ndjenjave dhe persekutimeve nga ana e shovinistëve serbë.

8. Ai shprehte një farë dyshimi lidhur me përkrahjen dhe lirinë që i është dhënë Kosovës, sepse thoshte: “Serbët gjithmonë kanë genë dinakë”.

9. Gjatë vizitës në Krujë, në përgjithësi, mbeti shumë i kënaqur, por pat vërejtje lidhur me ndërtimet e reja, të cilat janë krejt në kundërshtim me stilin e ndërtimeve të këtij qyteti muze.

Veçanërisht pat vërejtje lidhur me arkitekturën e Muzeut të Skënderbeut që është ngritur në kala.

10. Duke udhëtuar nëpër Shqipëri, i bëri përshtypje jo të mirë. Dhe, këtë e shprehu sinqerisht fakti se nëpër fusha punonin, kryesisht, gratë dhe vetëm pak burra. Ishte i etur të shikonte që në çdo qytet të valëviteshin sa më shumë flamuj kombëtarë.



Veçanërisht, tha: “Flamuj duhet të valëviten në Kalanë e Krujës, në Gjirokastër, në Tiranë etj.”

E, kur vajti në Vlorën e zbukuruar me flamuj të shumtë kombëtarë, me rastin e festës, u kënaq pa masë.

“Tani po më ngopet syri dhe zemra dhe po e ndjej veten tamam në Shqipëri”, tha.

11. Kur u largua iu dhuruan disa libra: “Gjenerali i ushtrisë

së vdekur”, “Përsëri në këmbë”, “Kështjella” etj.

12. Nga biseda rezultoi se ëndrra e tij ishte të luajë në film rolin e Skënderbeut.

13. Tha se nëna dhe motra e tij kanë kërkuar që të vijnë në Shqipëri, por ai shprehu shqetësimin nëse do u jepet viza.

“Nënë e kam plakë dhe ajo nuk dëshiron të vdesë pa e parë njëherë nënën Shqipëri”, tha ai.



Bisedë me punëtorë krahu...

# Atë ditë që i marrë 10 euro, fluturoj nga gëzimi!

*Sa herë që më bie puna të kaloj kah vendi që në Prishtinë njihet me emrin “Tregu i devizave”, shoh njerëz që pyesin: “U duhet punëtor?”  
“Jo”, ua kthej me keqardhje.*

Edhe këto ditë me mëngjese të ftohtë dimri, po kalove pranë vendit “Tregu i devizave”, deshe a nuk deshe të rrethojnë njerëz hallexhinj që kërkojnë punë. E, mu për këtë biseduam me disa sish...

## **SAMI AJETI, NGA PRISHTINA, 58 VJEÇ:**

- Jam njëri nga ata që e kaloj ditën në këtë vend, te “Tregu i devizave”, duke pritur që t’me merr kush për ndonjë punë. Kur gjej punë më duket sikur m’i falin ato para, e jo që i fitoj me djersën time! I kam pesë anëtarë të familjes. Nuk ka gjasa t’ua siguroj ekzistencën, sepse një ditë gjej punë e tri të tjera pres kot... E, shteti as që interesohet për ne! Nuk qanë kush kokën për ne!  
23 vjet e t’fui u bën pas lufte dhe çdo ditë e më shumë njerëzit janë duke u varfëruar. Andaj, sa më pak para të ketë populli, aq më pak kemi edhe ne, punëtorët e krahut, sepse s’na merr kush për punë...  
Paramendojeni: Kur nuk kanë razi politikanët tanë, çka presim nga shteti ne, të gjorët?!

E, qysh i kemi udhëheqësit tanë, ashtu i kemi edhe punët!  
Por, më se keqi po pësojmë ne, punëtorët e krahut, sepse jetën e kalojmë në rrugë, në pritje se a na merr kush për punë!

## **FITIM SADIKU, NGA PRISHTINA, 47 VJEÇ:**

- Më kanë humbur shpresat për ditë më të mira. Besimi na ka mbetur vetëm në Zotin, sesa për politikanët tanë e ka pasur puna jonë!  
Sepse, qeveritë po ndërrohen, e lopata kurrë s’mu hoq nga dora!  
Sepse, po deshën politikanët tanë do na gjenin nga një vend pune edhe neve, që me vjet të tëra qëndrojmë në rrugë, duke pritur se kush do t’na ofrohet, kush do na merr të punojmë qoftë edhe për një ditë...

## **BEKIM FERATI, NGA PODUJEVA, 33 VJEÇ:**

- Në grupin që rrimë “Te devizat” jam njëri nga më të rinjtë që presim punë.

Çdo mëngjes vij nga Podujeva. E, në mbrëmje vonë kthehem në Podujevë. Shkollën e mesme e pata lënë në gjysmë, sepse në atë kohë jetonim në fshat dhe kushtet i kishim edhe më të këqija se tash, edhe pse edhe tash jemi pus...  
Babën e kam invalid, kurse nëna është e sëmurë dhe shpirtin e mban me ilaçe. Jam më i madhi në familje, i martuar dhe baba i dy fëmijëve.  
Vij çdo ditë nga Podujeva për punë, por punë nuk gjej çdo ditë. Ka ditë kur tërë ditën pres, e në mbrëmje i hipi autobusit dhe kthehem me xhepat bosh...  
Andaj, desha e a s’desha pas Vitit të Ri do ia mësyj Evropës, e ishalla atje më del nafaka për punë, që t’ua siguroj kafshatën e bukës prindërve, gruas dhe fëmijëve”.

## **SI TA PËRMBYLL KËTË SHKRIM?**

Jetë të tillë si tre bashkëbiseduesit tanë bëjnë edhe mijëra e mijëra të rinj të tjerë në vendin tonë, të cilët mundohen ta sigurojnë kafshatën e gojës për vete dhe familjet e tyre... E, deri kur do të vazhdojë kështu, një Zot e di...

**Diturie Haxhaj**



# Gėzuar 2024



# Malli për korzonë e Prishtinës...

*Rruga kryesore e Prishtinës në vitet 70 ishte pikëtakim i të rinjve, kryesisht shkollarëve e studentëve, i intelektualëve dhe të tjerëve, e që krahas shëtitjeve në mbrëmje shkëmbenin mendime, por edhe fjalë dashurie...*

Dikur korzoja e Prishtinës tubonte njerëz të moshave e viseve të ndryshme. Kudo hasje në rini, pa tym duhani, por me muzikë të lehtë në ato pak kafene që ekzistonin në Prishtinë.

Vendi ku kënaqeshim, ku shkëmbenim përshëndetje, buzëqeshje, pra korzoja e Prishtinës, s'është më dhe lirisht mund të them: Na ishte dikur...

A kanë prishtinasit mall për korzonë e Prishtinës?

Në këtë pyetje përgjigjen të anketuarit tanë...

## ELEZI: NJË KUJTIM I PAHARRUAR

- Para pak ditësh i mbusha 75 vjet, andaj jam njëri prej atyre që i kam shijuar mbrëmjet në korzonë e Prishtinës. Unë në vitet 70 isha student i letërsisë dhe di se të shtunave e të dielave kur isha në vendlindje, në Ferizaj, më mungonin daljet në korzo dhe mezi prisja të hënën të vija në ligjërata e në mbrëmje me shokë të grupit takoheshim në korzo. Ishte një përjetim i bukur, madhështor, relaksues në të njëjtën kohë.

E, korzoja vazhdoi deri në vitin 1989, kohë kur Serbia futi gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë. Me këtë rast dalëngadalë u shua korzoja e Prishtinës dhe nuk u rikthye as pas lufte, edhe pse tash kushtet ekzistonin.

## SHEFKIU: KAM MALL PËR ATË KOHË...

- Në kohën kur isha nxënës në Normale, në mbrëmje, pas orëve të mësimi, gjithsesi

i jepnim nja dy a tre xhiro korzosë dhe tek pastaj shpërndaqeshim për në shtëpi. Sidoqoftë, edukata dhe kultura e asaj kohe dallohej nga këto që i kemi sot: njerëz të qetë e që bisedonin prajshëm hasje në korzonë e Prishtinës, e që ishin për lakmi. Pas kryerjes së Normales u punësova mësuës dhe pas një kohe edhe u martova. E veçanta ime ishte se pas martesë dilja me nusen time në korzo dhe, së paku, një orë e kalonim në shëtitje, herë vetëm ne të dy e herë-herë na bashkëngjitej edhe ndonjë shok imi.

Por, në vitet 90 gjithçka u rrënuar nga Serbia dhe bashkë me të u shua edhe korzoja e Prishtinës, sepse më nuk kishte siguri në rrugë, e sidomos rrugicave kur njerëzit ktheheshin për në shtëpitë a banesat e tyre.

Dhe, pavarësisht të gjithave, edhe pse tash e kemi lirinë, kam mall për korzonë e Prishtinës...

## TEUTA: VENDI KU TAKOVA TË DASHURIN!

- Eh, korzoja?! Ajo m'i kujton shumë gjëra, madje edhe dashurinë time, e cila më vonë u kurorëzua me martesë. Dhe, si të mos kem nostalgji për atë kohë, për korzonë e Prishtinës, kur mu në të edhe më lindi dashuria e jetës sime?

Aso kohe të rralla ishin vajzat që krijonin lidhje dashurie në shkollë, sepse profesorët të merrnin në sy për të keq dhe vajhalli, pastaj, për notat në shkollë...

E, korzoja ishte vendi ku krijoheshin lidhjet ndërmjet të rinjve, ku të vjetrit shkëmbenin mendime të ndryshme qoftë profesio-

nale, qoftë politike...

Gjenerata ime i kanë filluar lidhjet në korzo. Pastaj, janë martuar dhe shëtitur si çift i martuar, derisa janë bërë me fëmijë...

## MULI: SECILI E KIShte DRURIN E VET!

- Pse kam nostalgji për atë kohë?

Thjesht: dilnim në mbrëmje, freskoheshim nga vapa përcëlluese e ditëve të verës, përshëndesim të njohurit, rrinim njëri me tjetrin, e herë-herë edhe vetë mbështetur për ndonjërin nga drurët e shumë që gjendeshin anash në të dy anët e rrugës. Dhe, e veçanta ishte se secili e kishte drurin e vet dhe takimet i linim te "druri ynë", siç shpreheshim aso kohe.

Mallëngjyese, a?

E sot?

Vendi ku dikur bëhej korzo e Prishtinës është mbushur në të dy anët e rrugës me kafene, në të cilat, veç zhurmës, tymit të duhanit dhe lypsarëve e qenve endacakë, nuk gjen gjë tjetër...

Keq, a?!

## NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Mund të thotë kush çka të dojë, por sheshi i tashëm i Prishtinës nuk ngjason në shesh, por në një vend ku lypsarët me duar të shtrira të ndjekin pas, qentë endacakë lodrojnë si në "han" të vet, budallenj të zhveshur, të zbathur e të parruar enden si në xhungël, tupanxhinj që u mëshojnë tupanëve sa herë u teket...

E, çka jo tjetër?!

**Selim Rama**




2023  
4

The Last Call

# Gift Card

200€ Room and Dinner for Two



# Qytetet e patriotëve shqiptarë - pa shqiptarë!

*Dy qytetet, e që jo moti ishin të populluara me shqiptarë, Manastiri dhe Ohri, tash janë pa shqiptarë!*

Më 22 Nëntor 1908 në Manastir u tubuan patriotët më në zë të shqiptarisë dhe unanimisht morën vendimin për përdorimin e alfabetit shqip, të cilin e kemi sot.

Po ashtu, në atë kohë edhe Ohri ishte i mbipopulluar me popullatë shqiptare dhe ishte i njohur për njerëz patriotë të kohës: Hamdi bej Ohri dhe Dervish Hima apo i familjes Gropa, që ka qeverisur me Ohrin në Mesjetën e vonshme.

Por, me regjistrimin e fundit, ku nga

3000 shqiptarë sa ishin në regjistrimin e mëhershëm, në vitin 2021 janë vetëm 1900 sish!

E, kjo shihet edhe me numrin e nxënësve në klasën e parë. Kështu, në bankat shkollore në klasën e parë në Ohër, për vitin shkollor 2023-24, në shkollën e vetme ku mësohet shqip, në "Vëllazërim-Bashkim", janë regjistruar vetëm 13 nxënës

shqiptarë!

Ndërkaq, nxënës shqiptarë në shkollat të mesme të Ohrit nuk ka!

E, nëse vazhdon kjo tendencë e zvogëlimit të numrit të banorëve shqiptarë, Ohri, si më parë Manastiri, do të mbesin vetëm me një numër simbolikë të shqiptarëve.

Dhe, lirisht mund të quhen qytetet e patriotëve shqiptarë pa shqiptarë!

NË KËTË SHTEPI, PREJ 14  
DERI 22 NENDOR 1908-ËN U  
MBAJT KONGRESI I MANASTIRIT  
I ATDHETARËVE SHQIPTARË  
NË TË CILIN U PRANUA  
ALFABETI I TANISHËM SHQIP.

KËSHILLI PËR KREMTIMIN  
E GJASHTËDHJË TË VJETORIT  
TË ALFABETIT SHQIP



# Mërgimtarëve nuk u intereson si kemi jetuar dikur!

*Me të hyrë edhe me kalendar në dimër, ende koha është e nxehtë e me diell, tamam pranverë. Dhe, nuk kanë ndryshuar vetëm stinët, them me vete, teksa qëndroj në ballkonin e shtëpisë, por kanë ndryshuar edhe kurbetçarët.*

Teksa qëndroj në ballkonin e shtëpisë, shoh se oborret e fqinjëve janë mbushur me vutura me tabela nga jashtë.

Shumë kanë ndërruar kohët, mendoj me vete.

Ndërkohë, më ofrohet gruaja dhe më thotë: "Dukesh i mërziur!".

Mundohem të mos flas, por ta përjetoj në vete gjithë këtë ndryshim te njerëzit dhe stinët.

"A ke ndonjë mërzi, a?", më thotë.

"Jo. Por, shumë gjëra nuk janë askund. Pak më parë sapo kaloi këndej pari kushëri që ka ardhur nga Zvicra, e nuk jemi parë kaherë...

E kemi kaluar fëmijërinë bashkë. Në këtë kohë, zakonisht, dimrat ishin me borë deri në një metër".

"A këtë mërzi e ke, a?!", më thotë dhe vazhdon: "Një lagje me shtëpi i kanë

ndërtuar vëllezërit e motrat e mia dhe të gjitha janë të zbrazëta! Ti e di se kur shkoj në vendlindje, zakonisht, i vizitoj vetëm varret e prindërve dhe të vëllait të madh...

Pra, bëj vizitë në varre e jo në familje!

E, ti flet për kushërinjtë!"

Dhe, në vend të përgjigjes, i them: "Ti e ke mirë, por edhe unë nuk e kam keq!"

## LAKMON GOMARIN NGARKUAR ME BARRË!

Dhe, fill pas këtij muhabeti më kujtohen fjalët e një studenti, i cili studionte arabishten.

Ai, teksa i mësonte foljet (arabisht nasaret), teksa ecte nëpër mal, has në një njeri që e tërhiqte me litar një gomar të ngarkuar me dru.

Në çast, e sjellë në mendje: "Lehtë e

ke, o gomar, që bart në shpinë barrë, e nuk i mëson nasaret!"

E, ta lodhësh kokën me kushërinjtë nuk ia vlen...

Sepse, ata vijnë e shkojnë, e kanë harruar se dikur kemi jetuar së bashku në një shtëpi dhe kemi fjetur në të njëjtën odë...

E, ato gjëra më nuk kanë vlerë.

Sepse, vetëm Asllani, moshatar imi, kur vjen nga kurbeti më thërret për kafe dhe qanë duke folur për të kaluarën...

Dhe, teksa mendoj me vete se si njerëzit i ndryshojnë kohët, si e tjetërsojnë dashurinë njerëzore, si e humbin ndjesinë për tjetrin dhe si u shlyhet truri për më të dashurit, bëhem nervoz me vetveten dhe dal e eci nëpër mal si bishë e egër...

**Sokol Murturi**

Flash

# Rikthehet e mrekullueshmja Edona Zogu

Gjatë muajit që e lamë pas, Edona Zogu iu bashkua Televizionit "Klan Kosova" në cilësinë e moderatores. Ajo ka një karrierë të gjatë e të suksesshme televizive. Një kohë të gjatë ka punuar në KTV, por e braktisi atë. Sidoqoftë, gjithnjë ka qenë e pëlqyer nga publiku për paraqitjen dhe mënyrën e saj origjinale të udhëheqjes së edicionit informativ.

Në atë kohë flitej se Edona kishte vendosur të heqë dorë nga televizioni për t'iu bashkëngjitur Kompanisë "IPKO". Ndërkohë, Edona pat fituar bursë për studimet master në Universitetin "Sheffield" në Greqi.

E, rikthimi i saj në televizion është vendi ku ajo, pa dyshim, ndihet mirë dhe komode, meqë pamja, qëndrimi para kamerave, ngjyra e zërit dhe leximi rrjedhshëm, janë karakteristikat e saj si spikere e moderatore.



## Pse Big Mamës i vdesin shokët e ngushtë?

Big Mama i është falënderuese babait të saj për gjithçka që ka, meqë falë mbështetjes së tij, mundi t'i tejkalonte të gjitha sfidat në rrugën e saj.

Por, ajo në jetën e saj kaloi nëpër dy tragjedi, e në një prej të cilave desh humbi edhe vetë jetën.

Qëkur ishte 17-18 vjeçare ka humbur shokun e parë të ngushtë të jetës. Ndërroi jetë shoku i parë dhe për një vajzë 17-18 vjeçare ishte diçka e rëndë për t'u përjetuar. Më pas, në Strugë, prapë humbë një tjetër shok të ngushtë. Aty gati u mbytë edhe ajo vetë, por u kthye në jetë... "Ka ndodhur një incident para shumë vitesh. Ishim në liqenin e Ohrit me një motor uji. Ndodhi një problem, ramë nga motori, të dy e humbëm vetëdijen.

Se si na kanë nxjerrë, se si kemi shpëtuar nuk e di... Vetëm kur hapa sytë në spital. Mjekët na kthyen shpirtin dhe zemrën, por atij nuk i funksiononte më truri. Unë e kam pasur të shkruar të jem gjallë, ai ndërroi jetë", tha ditë më parë në një prononcim.



Genar 2024!



Prapoverë COSOVE

**UB**

**UNION BUSINESS**  
Albanisch & Deutsch

*Shëndet, suksese dhe dashuri në familjen tuaj!*





Osman Gazepi me dy vajzat partizane

## Njeriu më besnik i mbretit Zog - vdiq i pastrehë dhe në vetmi!

*Njeriu më besnik i mbretit Zog, Osman Gazepi, nuk u arratisë me të kur mbreti iku nga Shqipëria, por vendosi të qëndrojë. Në kohën e luftës dy vajza i pati partizane, një djalë dëshmor, e vet vdiq i pastrehë dhe në vetmi!*

Osman Gazepi ka qenë ushtarak i trupave Perandorake turke dhe pjesë-marrës në luftimet e otomanëve me

trupat koloniale angleze në Çanakala dhe Galipoli. Pastaj, u kthye në Shqipëri, ku ngjiti shkallët e karrierës ushtarake në krah të politikanit të ri nga Mati, Ahmet Zogut.

### ... E ARRESTOI ATENTATORIN E AHMET ZOGUT

Bëhet një prej njerëzve më të besuar të tij dhe personi që arreston në Parlament atentatorin e Ahmet Zogut, Valter Beqirin.

Por, pas ikjes së Ahmet Zogut nga vendi, nuk dihet përse Zogu nuk e mori me vete, ndoshta mosha e kaluar apo dëshira e vet kolonelit për të qëndruar në Shqipëri.

Pas arratisjes së Zogut, Osman Gazepi u tërhoq në shtëpinë e tij në Leskovik. Më 1945 u arrestua si besnik i Zogut, akuzë për të cilën nuk u ankuar, pasi ishte realisht i atillë.

U lirua nga burgu pas 8 vjetësh, me ndërhyrjen e Ministrit të Brendshëm, Mehmet Shehut.

### FUNDI TRAGJIK I OSMAN GAZEPIT

Por, edhe pse i kishte dy vajza partizane dhe një djalë dëshmor, Gazepi mbeti vetëm: pa shtëpi, pa strehë, ndaj pati një fund tragjik. E gjetën të vdekur nën një urë. Mjeku që bëri raportin shkruante se kishte vdekur nga uria dhe sëmundjet e morrit.



# O sa mirë me qenë shqiptar!

*Dashuria ndaj atdheut nuk është obsesion, por pasion shpirtëror. Dashuri që nuk mund ta shpjegosh, por as ta largosh. Para së gjithash, në psikologjinë tonë konsiderohet si një ndër vlerat vendimtare për orientimin e zhvillimit personal dhe identitetit tonë si individ.*

Ndërdija kolektive e një shoqërie bartet ndër breza, sikur edhe te ne, ku ne, si shoqëri, vlerat tona etnike i neglizhojmë shumë shpesh, duke i shikuar nga larg dhe të metat s'i heqim, duke krijuar pavetëdije ndjenja faji dhe paragjykime për atë që jemi!

## KUSH KA TË DREJTË TË JAPË KËSHILLA?

Ata të cilët e kanë braktisur atdheun, si rasti im, nuk kanë shumë të drejtë të japin këshilla se sa e rëndësishme është për mirëqenien tonë të kesh fatin të jetosh dhe të veprosh në vendlindje.

Mirëpo, nga ana profesionale, duke ditur se ndihma më e madhe që mund t'i japësh dikujt është ta mësosh, së pari, ta vlerësojë veten dhe si të ndihmojë vetveten.

Ndoshta, një këshillë thelbësore për të gjithë të rinjtë tanë që, fatkeqësisht, ditë e më shumë po e braktisun atdheun.

Ju, edhe pse lëvizni nga vendlindja, nuk jeni vegël e as viktimë e askujt, edhe pse Evropa gjatë historisë ka "ndërgjegje" për NE si popull! Ne jemi autoktonë dhe jo endacakë. Jemi më shumë se kurrë të ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm për atë që jemi dhe duam të jemi. Secili nga ne është ambasador në vete, kudo që jemi. Për të gjithë mërgimtarët e "ri", mos harro se Ti je ai që kontribuon në botë, jo bota në ty! Vlerësoje veten dhe mos e ulë kokën! Ndjehu krenar që je shqiptar dhe kurrë mos u ndjej i pavlerë për atë që je!

Ndjenjën e të qenit fajtorë e kemi bartë ne, para teje, me dekada dhe për këtë pendohe mi, andaj gjithmonë bëhu guximtar për ta mbrojtur me nder identitetin e gjyshërve tanë dhe ke parasysh thënien e fuqishme "O sa mirë me qenë shqiptar!"

Shkëndije Pacolli



PRAXIS FÜR  
PSYCHOLOGISCHE  
BERATUNG  
Shkëndije Berisha Pacolli



+49 152 33 63 07 73



info@pacolli-praxis.de  
www.pacolli-praxis.de



Boschring 6  
56422 Wirges

Shkëndije Pacolli



# O, ku je, arsimtarja më e mirë?!

Ditë më parë, teksa dilja nga Redaksia, një zonjë vinte drejt meje, teksa pas meje ndodhej një grup 4-5 të rinjsh, nxënës. Ecjen e bënin me të qeshura, që dëgjo-heshin goxha larg...

Por, ajo që më befaso i ishin fjalët e njërit prej tyre, i cili, kur u afrua zonja afër meje, i tha me zë të lartë: "O, ku je, arsimtarja më e mirë?!".

E, fjalët e tij më shumë ishin tallje sesa fjalë serioze!

Dhe, mu për këtë, zonja (arsimtarja), u ndie keq, veçmas që e dëgjova unë.

E, në vend të përgjigjes, ajo heshti dhe vazhdoi rrugën.

Por, gjesti i tillë, i keq, më ktheu me mendje në kohën kur isha nxënës i Normalës së Prishtinës, kohë kur ne, nxënësit normalistë, për të mos i dalë profesorit sy më sy, lakonim rrugën kinse nuk ishim duke shkuar në atë drejtim.

E, edhe po të takoheshim me ndonjë profesor, një edukatë e tillë e nxënësit të cilin e pashë vetë as që do të vinte në shprehje, sepse ishim me edukatë dhe bonton krejt tjetër...

Para se t'i përshëndetnim profesorët, duart i nxirrim nga xhepat, e shikonim profesorin në sy, madje me një skuqje në fytyrë, në shenjë respekti.

Veçmas, në orët e mbrëmjes as që kishim

dëshirë të takonim ndonjë profesor, sepse, të nesërmen, posa hynte në orën e mësim-it, të drejtohej me fjalët: "Ngrihu në këmbë dhe na e shpjego mësimin e fundit, sepse po ke kohë të bredhësh edhe në orët e vona të mbrëmjes nëpër qytet!".

Sidoqoftë, i arsyetonim edhe profesorët e tillë, sepse nxënësi në orët e vona të natës do të duhej të ishte në shtëpi dhe me

libër në duar, e jo duke bredhur si të ishte ndonjë hajn...

Dhe, thënë shkurt, një disipline të tillë, një edukate të tillë, ia kemi parë hajrin, sepse as tash, në moshën 70 vjeç që jam, nuk ndodh ta përshëndes kënd në rrugë me duart në xhepa, qoftë ai edhe fëmijë.

**Selim Rama**

Radio,  
Lajme, Moti,  
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin  
**shkabaj** për Android

ANDROID APP ON  
Google play



# BOOM

*Të famshmit shqiptarë  
që i thanë lamtumirë  
beqarisë në vitin 2023*

*Të famshmit shqiptarë  
që u gëzuan me fëmijë  
në vitin 2023*

**“NIN”, Anina Papasergio -  
ylli i ri i muzikës  
me shkëlqim verbues**

Anina Papasergio, me emrin artistik "NIN", është një talente e rralë dhe një shpërthim i freskët në skenën muzikore.

Anina, e cila po studion kanto moderno në Konservatorin "Claudio Monteverdi" në Bolzano, ka filluar udhën e saj si kantautore dhe pianiste që në moshën e hershme, duke bërë që pasionin për muzikën ta shprehë qysh në moshën shtatë vjeçe.

Ajo ka sfiduar skenën kombëtare dhe ndërkombëtare, duke marrë pjesë në shumë kompeticione dhe duke shkëlqyer në secilën prej tyre.

Albumi i saj i parë, i regjistruar në Londër në vitin 2019, me ndihmën e producentit të njohur Sky Adams, është një pikë kulmore në rrugëtimin e saj artistik.

Videoklipet që shoqërojnë këtë album presin me pa durim të ndajnë bukurinë dhe pasionin e muzikës së Aninës me ndjekësit e saj të përkushtuar.

Anina vjen me intervistë në numrin special të shtojcës "Boom"...



**"NIN", Anina Papasergio - ylli i ri i muzikës me shkëlqim verbues**



## Një prezantim i juaji?

- Jam Anina, artiste e pasionuar. Jam e lindur në Bolzano, më 12 maj 2004.

Origjina ime është nga një mama shqiptare nga Vlora dhe një babai italian nga Reggio Calabria.

E kam përfunduar shkollën muzikore "Josef von Aufschnaiter" dhe liceun e gjuhëve të huaja "Walther von der Vogelweide".

Flas në mënyrë të përsosur gjuhën gjermane, angleze, italiane dhe shqipe.

Aktualisht jam studente në Konservatorin "Claudio Monteverdi" në Bolzano, ku po i thelloj njohuritë e mia muzikore.

Për të pasuruar përvojën time, pjesëmarrja në kurse formimi ka qenë një pjesë e rëndësishme e rrugëtimit tim artistik.

Tre vite me radhë kam marrë pjesë në SUMMER MUSIC CAMP, një shkollë formimi e produktorit të mirënjohur italian Mogol, për autore dhe këngëtare al Centro Europeo Toscolano (CET). Gjithashtu, dy vjet kam marrë trajnime individuale në Salisburg me vocalcoaching Robin D.

Në muajt shtator, tetor dhe nëntor të vitit 2019, kam pasur një bashkëpunim të veçantë me produktorin e njohur londinez, SKY ADAMS, për krijimin dhe regjistrimin e diskut tim të parë.

Jam e përkushtuar për të zhvilluar karrierën time muzikore dhe për të sjellë një ndikim pozitiv në botën e muzikës. Pres me pa durim të shoh se çfarë sjell e ardhmja dhe jam e gatshme për sfidat dhe aventurat që do të vijnë...

## Kur ke nisur të këndosh dhe kush e zbuloi talentin tënd?

- Pasionin për këngën e kam pasur qëkur isha shumë e vogël. Për mua çdo ditë niste dhe mbaronte me tinguj dhe melodi të ndryshme.

Personat që njohin dhe vlerësojnë talentin tim janë prindërit e mi, veçanërisht mamaja ime. Ajo gjithmonë ishte pranë meje dhe më ka ndjekur hap pas hapi në çdo aktivitet të jetës sime.

Në momentet kur qëndronim në shtëpi, unë shpesh këndoja, ndërsa mami regjistronte çdo këngë apo kërcim që interpretoja me pasion.

Dhe, kjo përkujdesje dhe vëmendje e veçantë bën që në moshën 3 vjeçe mami t'më regjistroj në Institutin Muzikor "Vivaldi".

E pa këtë si një mundësi të jashtëzakonshme për të zhvilluar talentin tim dhe, kështu, ndoqa programin e tyre për 3 vjet.

Pas kësaj periudhe vazhdova studimet për 3 vjet të tjera në të njëjtin institut, duke përqendruar vëmendjen time te muzika e pianoforte-s.

## Duartrokitjen e parë e more nga...?

- Duartrokitjen e parë e mora në moshën 11 vjeç, më 7 shkurt 2015, duke performuar këngën "Happy", të Pharrell Williams, në një koncert bamirësie, të organizuar nga CHER-NOBYL ALTO ADIGE SÜDTIROL, që pat



një audiencë prej 500 pjesëmarrësish. Dhe, teksa duartrokitjet më mbushën me emocione, unë, duke u larguar nga skena, vrapova te mami dhe, duke e përqafuar, i thashë se kisha gjetur rrugën time, të ardhmen time në botën e muzikës dhe e pyeta: "Kur do të jetë koncerti i ardhshëm?".

## Personi që të inkurajoi fuqishëm në rrugën e muzikës?

- Do të thosha, personat që më inkurajojnë fuqishëm në rrugën e muzikës janë, natyrisht, familja ime e madhe. Kur them "familja ime e madhe", përfshij jo vetëm babanë, mamin dhe vëllanë, por edhe të gjitha tezet me familjet e tyre.

Ne jemi shumë të lidhur me njëri-tjetrin. Familja ime ka qenë dhe mbetet mbështetja dhe inkurajimi, si nga ana financiare e shpirtërore, gjatë gjithë këtij udhëtimit në botën e muzikës.

## A të kujtohet kënga e parë që e këndove dhe cila të dha besim për të hapëruar suksesshëm në këtë fushë?

- Po, patjetër. Në moshën 4 vjeçe kam kënduar për të marrë pjesë në "Zecchino d'oro" këngën "Quell'anello d'oro".

## Ju ndani skenën me yje të mëdhenj të muzikës. Si e përshkruani këtë ndjenjë?

- Kjo përvojë është një emocion i jashtëzakonshëm. Për mua, ndarja e skenës me yje të muzikës është një përjetim euforik, një ndjenjë e paharrueshme e lumturisë dhe krenarisë. Besimi dhe mundësia që më japin artistët e mëdhenj janë frymëzim dhe inkurajim.

Megjithatë, është një përvojë që vjen me një përgjegjësi të madhe.

Sepse, të jesh pjesë e skenës së muzikës do të thotë që duhet të japësh maksimumin tënd në çdo moment dhe t'i përballosh sfidat me siguri dhe profesionalizëm.

Ndjenja e tensionit është një pjesë natyrale e kësaj përgjegjësie, por, njëherësh, është një motivim për të përmirësuar veten dhe për të bërë shfaqjet më të mrekullueshme për audiencën.

Është një balancë mes emocionit dhe

përgjegjësisë që e bënë këtë përvojë edhe më të veçantë.

## Ku dhe përkrah kujt e keni ëndërr të këndoni?

- Ëndrra ime është të shkoj në skenë dhe të këndoje pranë një artiste të shquar si Rihanna, ikonë e muzikës që më ka frymëzuar qysh nga fëmijëria. Imagjinoj veten në krah të saj, duke ndarë dritën dhe pasionin për muzikën përpara një audience të vështirë për ta harruar.

Po ashtu, Dua Lipa është një tjetër artiste që e shoh si një ëndërr për t'u realizuar. Suksesi i saj dhe mënyra se si e përfaqëson diversitetin dhe fuqinë e artisteve femra, bën që të ndihem krenare dhe dëshiroj të përbashkëtoj skenën me të.

Imagjinoj një performancë ku bashkëkëndojmë si bashkatdhetare dhe ndajmë një lidhje të thellë muzikore me publikun.

Këto ëndrra janë burim i pafund motivimi për mua dhe, shpresoj, një ditë t'i bëj ato realitet.

## Çfarë presim nga ju në vitin 2024: planet, projektet?

- Për vitin 2024 pres të kem një vit të ngarkuar me sfida dhe suksese.

Përveç përqendrimit në shkollë, kam disa projekte që janë në zhvillim dhe, natyrisht, do t'i ndaj me publikun tim në të ardhmen.

Një nga momentet më emocionuese do të jetë publikimi, së shpejti, i videoklipit të këngës "FEELING", këngë nga albumi im i parë, që shpresoj të përfundojë gjatë vitit të ardhshëm.

Është një projekt i rëndësishëm për mua, për të cilin kam filluar të punoj që nga viti 2019, por u ndërpre shkaku i pandemisë Covid 19 dhe tani po e çoj përpara me produktorin dhe kompozitorin e mirënjohur britanik Geoff Westley.

Pres që ky vit të jetë një rrugë e pasur me arritje dhe përvoja të reja dhe shpresoj që të gjithë fansat dhe mbështetësit e mi të kenë mundësi të marrin pjesë në këtë udhëtim të muzikës dhe artit.

**Nderim Neziri**

# Të famshmit shqiptarë që i thanë lamtumirë beqarisë në vitin 2023

*Viti 2023 ishte një vit i gjatë, por me pak dasma nga yjet tanë... E, disa nga figurat tona publike, e që i dhanë fund beqarisë, janë, Luizi dhe Kiara, Arbana dhe Eduardi, Egliti dhe Klea, Argjenda Doci dhe Jetmiri, Ilirjana dhe Adri, Venera dhe Lindi, Adelina Hasani dhe Besarti.*

Dita-ditës dasmat po bëhen private me miq e familjarë dhe larg syrit medial.

Por, dy nga dasmat sivjet u bënë drejtpërdrejt me publikun: një në Shqipëri e një në Kosovë, në kuadër të "Big Brother".



## ELGITI DHE KLEA

Një dasmë e komentuar deri në detaje është edhe ajo e Elgitit dhe Kleas.

Çifti atë ditë të veçantë e bënë publike me ndjekësit e tyre.

Bukurinë dasmës ia shtoi edhe djali i tyre, Kridi.



## ARBANA DHE EDUARTI

Një dasmë, pas shumë vite lidhjeje, ishte edhe ajo e Arbanës dhe Eduartit.

Çifti dasmën vendosën ta bëjnë në Toskanë, larg syrit të medieve. Në një ambient tejet privat dhe luksoz, Arbana dhe Eduarti kurorëzuan dashurinë e tyre.

## LUIZI

### DHE KIARA

Një nga dasmat që bëri jehonë të madhe është ajo e Luizit dhe Kiarës. Dasmë kjo që u komentua shumë, ku, pas një rrugëtimi të shkurtër në një format televiziv, dyshja vendosi t'i thotë "PO", njëritjetrit.

Kujtojmë se tash Luizi dhe Kiara janë në pritje të ëmbël të një vajze.








### VENERA DHE LINDI

Një dasmë madhështore ishte edhe ajo e Venerës dhe Lindit. Bëri bashkë shumë figura publike, por rregull ishte mospublikimi i dasmës në rrjete sociale, edhe pse çifti atë ditë e shfrytëzoi të krijojë disa hite muzikore dedikuar një-tjetrit.



### ARGJENDA DOCI DHE JETMIRI

Dasma që habiti ndjekësit ishte ajo e paparalajmëruar e Argjendës dhe Jetmiri.

Lidhja u bë publike vetëm në ditën e dasmës!

### ADRI DHE ILIRJANA

Një dasmë që u bë në syrin e mijëra shikuesve është ajo e Adrit dhe Ilirjanës. “Big Brother Vip Kosova” organizoi dasmën deri në detaje, në mënyrë që çifti të shkëlqente më shumë se kurrë. Të pranishëm ishin edhe prindërit e çiftit.



### ADELINA HASANI DHE BESARTI

Një dasmë që u komentua shumë është edhe ajo e gazetares dhe moderatores së njohur Adelina Hasani.

Adelina vendosi që dashurinë e saj ta kurorëzojë në Maldive. Por, nuk i mjaftoi kjo, meqë Adelina po organizon dasmë madhështore, e cila pritet të jetë në fund të këtij viti.

**Edona Vllasaliu-Bajoku**

# Të famshmit shqiptarë që u gëzuan me fëmijë në vitin 2023

*Epiteti prind është, pa dyshim, kënaqësi. E, viti që po e lëmë pas u dhuroi dhuratën më të çmuar disa personazheve tanë të njohur...*



## GËZIMJA DHE HAMI

Ky vit solli edhe një dhuratë speciale për çiftin e njohur Gëzimen dhe Hamin. Është djali i tyre i vogël, Joni, i cili iu shtua familjes Hamzaj.



## FIFI

Fifi sivjet u bë femra më e lumtur me ardhjen në jetë të djalit të saj, Theo Mal. Lindjen e djalit Fifi zgjodhi ta bëjë në Amerikë.



## LYRICAL SON

Edhe për reperin Lyrical Son viti që po e lëmë pas mbetet gjithmonë në kujtime. Ai mori epitetin baba për herë të tretë. Pas dy vajzave, reperi u bë me djalë, të cilin e pagëzuan Andreu.



## KLAJDI HARUNI

Edhe për Klajdin ky vit ishte i mbushur me shumë surpriza. Ardhja në jetë e vajzës së tij, Heas, ia zbukuroi jetën këngëtarit.

**Denisa  
Oruqi**

## XHENSILA

Pak para festave të fundvitit, Xhensila mori dhuratën më të bukur, djalin Amen. Djali përmbushi familjen e Xhensilës dhe Besit.





# BOOM

*exclusive*



*Flow, ylli i ri  
i muzikës që premtan  
hite në vitin 2024*

*Sivjet kujt nga  
personazhet tanë  
iu thye zemra?*

**Jeta Canaj,  
femër luksoze që  
"shihet nga aeroplani"!**

# Jeta Canaj, femër luksoze që “shihet nga aeroplani”!

*Jeta Canaj, e njohur si femër e suksesshme, e guximshme dhe e pashme. Është profesioniste e dëshmuar e fushës së bukurisë dhe shembull e model i femrës që ia del në jetë. Jeta ka pasur një vit të gjatë, me shumë punë e angazhime, por ia ka dalë të triumfojë e të shkëlqejë. Kur bëhet fjalë për pamjen, Jeta Canaj është nga ato femra që bie në sy me kilometra larg, siç thotë populli “shihet nga aeroplani”.*







**Jetë, si ia del të jesh shumë aktive në punë, në jetë, me udhëtime?**

- Kështu jam mësuar. Unë nuk mund të rrijë e ta shikoj botën teksa lëviz. Dua të jem edhe unë në lëvizje, të mos ndalem.

**“Studio Jeta” gëzon shumë suksese. Si ndihesh?**

- Është puna me përkushtim ajo që na ka mundësuar një klientelë të gjerë dhe besnike. Unë, bashkë me stafin, gjithmonë japim më të mirën dhe, pa dyshim, për krejt suksesin e “Studio Jeta” ndihem tejet krenare.

**Dukesh gjithmonë në top-formë. Si ia del?**

- Asnjë njeriu nuk duhet t'i mungojë kujdesi ndaj vetes. Shumë femra, përgjithësisht, priren të kujdesen për të gjithë, duke e lënë veten pas dore.

Unë punoj shumë, jam e dedikuar ndaj familjes, por i kushtoj kohë e rëndësi edhe vetes sime.

Ia dalë, sepse, kur ke vullnet dhe motiv, ia del çdo gjëje...

**A ka femra që vijnë në studio dhe kërkojnë të duken si ti?**

- Ka pasur raste kur u kanë pëlqyer flokët ose diçka specifike dhe kanë kërkuar. Më bëhet qejfi, ama njerëzit janë të ndryshëm dhe secili e ka bukurinë e sharmin e vet.

**Stili yt është ekstravagant e shumë seksi. A merr komente?**

- Kjo jam unë, nuk bëj kompromise shkakut i mendimeve të të tjerëve, edhe pse më duhet të them se komentet gjithmonë janë pozitive.

**Për fund?**

- Kushtoni vetes rëndësi! Harroni paragjykimet, ecni përpara dhe mendoni vetëm për qëllimet tuaja!

**N. Neziri**

# Sivjet kujt nga personazhet tanë iu thye zemra?

Viti 2023 nuk ishte edhe aq i mbarë në dashuri për disa nga fytyrat publike...



## DAFINA DHE DJ GEEK

Kur është fjala për të Dafina Zeqirin, në muzikë ishte shumë e suksesshme. Por, jo edhe në dashuri. Dafina dhe Dj Geek i dhanë fund lidhjes së tyre që në muajt e parë të këtij viti, e arsyeja ishte një hap madhor që këngëtarja donte të ndërmernte në lidhje me të ardhmen e tyre.



## FERO DHE ARBENITA

Pas shumë mosmarrëveshjeve, përplasjeve virtuale me njëri-tjetrin dhe sfidave të një pas njëshme, çifti i dhanë fund lidhjes së tyre. Arbenita e ka denoncuar Feron për dhunë fizike, kurse ai ka treguar se do të padisë për rrëmbimin e vajzës së tyre, Ninas.



## OLSI BYLYKU DHE EGLI TAKO

Olsi dhe Egli ishin në lidhje 5 vjet, ku në publikun e gjerë u njihen si çift tejet simpatik. Por, gjithçka ndryshoi. Gjatë këtij viti ata treguan se raporti mes njëri-tjetrit nuk shkonte ashtu siç duhej, andaj çifti i dha fund lidhjes së tyre.

## GETINJO DHE VIVIEN THANO

Ndryshe nga çiftet e tjerë, Getinjo dhe Vivien romancën e tyre e filluan në syrin e publikut në reality shou "Big Brother VIP Kosova". Ndarja e tyre erdhi si pasojë se Viven në një studio televizive deklaroi se Getinjo luan kumar. Por, këtë e ka mohuar reperi.



## LEDRI DHE SARA

Menaxheri i Ledri Vulës javë me parë ka konfirmuar se Ledri dhe Sara janë ndarë, si pasojë e asaj se nuk kanë gjetur gjuhë të përbashkët. Por, nga çifti nuk ka konfirmim...

**Xheneta Spahiu**



# Flow, ylli i ri i muzikës që premtion hite në vitin 2024



Flow është një nga artistët e rinj më prem-tues, që ka sjell frymë të re në botën e muzikës dhe nuk e ka ndërmend të ndalet.

Flow është unik, ndryshe dhe gjithmonë gati për më të mirën në skenë dhe industrinë e muzikës.

Kënga më e dashur për të është "Djali nga Kosova", këngë kjo që e ka për zemër, meqë lidhjen me vendlindjen e ka tejet të fortë.

Ndërkohë, "Me ty" është kënga që e afroi më shumë me publikun e gjerë.

Flow e ka pikë të dobët babanë. Thotë e ka babë, shok dhe çdo gjë.

Këngëtari i ri dhe i talentuar pak ditë më parë ka lansuar këngën e re me titull "Dashni haram", një produkt muzikor nga Bini Diez dhe XI Films.

## Torta e Vitit të Ri

# Lindita Elshani, nga "Lindas Kuchen Welt", me recetën e tortës fantastike për Vit të Ri

"Lindas Kuchen Welt", e maestros së tortave, Lindita Elshani, e cila jeton dhe vepron në Zvicër, tashmë njihet gjerësisht dhe kjo falë cilësisë dekor-eve unike dhe, sigurisht, shijes e korrektësisë.



### TORTA FESTIVE - RECETA

#### Përbërësit:

- Petë me bajame;
- 55 gr gjalpë të ftohtë;
- 50 gr bajame të bluara;
- 15 gr sheqer;
- 60 gr mill;
- Pak kripë;
- 15 ml ujë të ftohtë;
- Petë të bardha;
- 290 gr miell;
- 12 gr pluhur për pjekje;
- 7 gr ekstrakt të bajameve;
- 250 gr sheqer;
- 170 gr gjalpë (nga temperatura e dhomës);
- 240 ml qumësht;
- 150 gr të verdhë të pesë vezëve

#### Masa me mjedra:

- 200 gr mjedra;
- 50 gr sheqer;
- 15 ml lëng limoni.

#### Kremi:

- 300 gr gjalpë (temp. dhomë);
- 397 ml qumësht i kondensuar;
- 5 gr ekstrakt vanilje.

#### Dekorimi:

- Mjedra;
- Rosmarinë;
- Ribizlla të kuqe;
- Sheqer pluhur.

Përgatitja për petën me bajame bëhet nga të gjithë përbërësit e shkruar, vetëm uji i shtohet në fund deri sa të kombino-het brumi.

Shtrihet në formë për pjekje 20 cm.

#### Përgatitja:

Mjedrat me përbërësit e cekur më parë i ziejmë 10 minuta dhe i kullojmë farat (të ftohet krejtësisht).

Petët e bardha bëhen, po ashtu, nga të gjithë përbërësit, vetëm 100 gr sheqer i lini për ta bërë në një enë tjetër masën me vezë, duke i rrahur me mikser deri të bëhet masa stabile e bardhë dhe i kombinoni të gjitha bashkë ngadalë (jo me mikser).

#### Pjekja:

Enët për pjekje 2x20cm. Piqet në 180°, 20-25 minuta. E lini të ftohet krejtësisht.

#### Për kremi:

Gjalpi rrihet me mikser për 10 minuta. Pastaj, ja shtoni ngadalë qumështin e kondensuar si dhe vaniljen dhe vazhdoni t'i rrihi edhe 5 minuta derisa të kombinohet mirë kremi.

#### Renditja:

Vendosim petën e bajameve, lyhet me xhem kajsie (pa copa), shtohet pak nga kremi dhe vendoset peta tjetër, pastaj masa me mjedra vendoset në mes, kurse rreth e rrotull kremi, e pastaj vendoset peta e fundit.

\*

Linda tregon edhe për biskotat që nuk mungojnë asnjëherë në tryezën e saj festive.

Ju bëftë mirë dhe gëzuar festa e Vitit të Ri nga receta e Lindës!

Lindita përgatitjen e tortave e ka pasion dhe profesion.

Mjeshtrja e tortave na tregon se viti 2023 ishte i mbushur me punë, stres e suksese. E mira është se ia ka dalë t'i realizojë të gjitha ato që ka dashur, pavarësisht streseve që ka kaluar.

Linda për revistën tonë, "Kosovarja" tregon se gjëja më e veçantë e këtij viti në ikje ishte vizita në Itali me arbëreshët për festën "Hora e Arbëreshëve", që për të ka qenë një eksperiencë e paharruar. "Gjithashtu, gjatë këtij viti isha në Londër te "Peggy Porche", që është një nga personalitetet shumë të njohur për torta dhe ëmbëlsira, ku shkojnë njerëz nga e gjithë bota.

Ishte diçka magjike, pasi aty e festova edhe ditëlindjen e 16-të të vajzës sime.

Dëshira ime është që në vitin 2024 të mbaj një kurs profesional te "Peggy Porche", thotë Linda, e cila tregon se nuk do të ndalet së bëri më të mirën për klientët e saj të shumtë, ndërkohë që sërish gjen rast të tregojë mirënjohjen e saj për mentoren e parë, specialisten shqiptare të tortave, Mirin.

Linda nga "Lindas Kuchen Welt", në numrin festiv të "Kosovares", sugjeron për të gjithë recetën e tortës së festës me shije fantastike.





allure®  
BEAUTY

WE WISH YOU

**GOLDEN  
HOLIDAYS!**



Të skenës...

# Burrë e grua këngëtarë

*Në skenën tonë muzikore disa nga këngëtarët tanë jo që këndojnë vetë, por këndojnë edhe gratë e tyre...*



## AFRIM MUQIQI DHE HALIME MANI

Afrim Muqiqi është nga këngëtarët më të njohur në vendin tonë. Me këngët e tij, e që çdo herë kanë qenë hite, ai do herë e ka bërë publikun për vete.

Këngët e tij, qofshin edhe ato që janë kënduar në vitet 90, këndohen dhe dëgjohen me ëndje edhe tash. Por, edhe gruaja e tij, Halime Mani, njihet për një mori këngësh të suksesshme...



## NAIM ABAZI DHE MIHRIE BRAHA

Janë një nga çiftet më të përfolur të estradës.

Dhe, pavarësisht moshës, po arrijnë mjaft mirë t'i mbijetojnë tregut dhe konkurrencës.

Madje, janë tejet aktivë me koncerte e emisione të ndryshme televizive. Çifti është gjithmonë aktivë, atraktivë dhe në formë...



## NYSRET MUQIQI DHE MERITA SPAHIU

Jeta i bashkoi në muzikë, e ata e forcuan lidhjen për të mos u ndarë kurrë. I dhanë kuptim këngës, duke bashkuar talentin me dashurinë për njëri-tjetrin. E, tash njihen si bashkëshortë e prindër të përkushtuar. Familjarisht artistë të muzikës.

Talentin e prindërve këngëtarë e trashëgoi edhe djali i tyre, Albatriti, i cili tash është këngëtar i suksesshëm dhe i dashur për publikun.





Happy  
*New Year!*  
**remos**<sup>®</sup>

*Prime  
Viti i Ri!*

📷 [remos\\_restaurants](#)

🎵 [remos\\_restaurants](#)

[www.remos-restaurants.de](http://www.remos-restaurants.de)



# Burrin nuk e zë gjumi, *mendon se po e tradhtoj!*

*Nuk ka gjë më të keqe në dashuri se xhelozia. Nga xhelozia burri im i humbi të gjithë njerëzit që na rrethonin, madje edhe më të dashurit e tij, vëllanë dhe djalin e axhës!*

Isha 18 vjeçe. Në atë kohë isha e re dhe e bukur. Sapo e kisha kryer shkollën e mesme, e që në atë kohë mësimi mbahej në shkollën e fshatit tonë, në rrethinën e Deçanit. Dhe, fill pas kryerjes së shkollës së mesme, prindërit deshën të më rehatonin dhe, vërtet, më "rehatuan" me një njeri 30-vjeçar nga Peja, por i krisur nga xhelozia.

**EDHE VËLLANË E VET  
E AKUZONTE**

**SE MË SHIKONTE MUA!**

Qesharake, por edhe vëllanë e vet e akuzonte se më shikonte vetëm mua!

Dhe, si erdhi te ky rast?

Një ditë im burrë pat shkuar në treg për të blerë pemë e perime. Nuk e kishim dëgjuar kur ishte kthyer.

Kur hyri në kuzhinë na pa vetëm mua dhe kunatin, edhe pse unë isha në kuzhinë duke i larë enët, kurse kunati ishte shtrirë në shtrat dhe e shikonte televizorin.

Gati sa nuk u çmend...

Jo vetëm mua, por edhe vëllait të vet nuk la gjë pa i thënë...

Bile, edhe fjalët: "Ti po ma do gruan! E kam parë se si e shikon!".

Ai brofi në këmbë dhe e bëri grushtin gati t'i mëshojë, por shpejt u gjenda në mes tyre dhe u mundova t'i qetësojë. Pas pak të dy dolën nga dhoma. Në korridor dëgjova zhurmë. Kur dola në korridor të shihja se çka po ndodhte, ata veç ishin grushtuar... Dhe, që nga ajo ditë kunati doli nga

shtëpia. U ndjeva keq, sepse s'kishte bërë kurrfarë faji i gjori...

**AS NUK FLISNIM  
NDËRMJET VETI,  
AS NUK NA VINTE KUSH!**

Në fakt, kunati u kthye pas dy ditësh dhe më nuk hynte në kuzhinë. Nisi të jetojë vetëm në dhomën e tij dhe as që fliste me tim burrë.

Ishte katastrofë ajo jetë: as nuk flisnim ndërmjet veti, as nuk na vinte kush, as nuk shkonim kund...

Dhe, duke mos pasur kujt t'i gjuhej më me fjalë, im burrë më bërtiste mua, se unë, sipas tij, isha ai strumbullari i gjithë asaj katrahure. E, strumbullari ishte vetë...


Por, meqë e dija se familja ime do të shqetësohej po t'u tregoja, e mbaja në vete dhe kam vuajtur shumë, derisa më lindi fëmija i parë dhe më nuk kisha kohë të merresha me budallakitë e tij, por i kushtohesha vajzës sime, të cilën ma fali Zoti si drita.

**Valbona M.**



**FLEX**  
GYM

URIME VITI I RI  
**2024**





# Vjedh fëmijë e shit në Amerikë!

*Nëna nuk di ku e ka fëmijën. Loton dhjetë vjet vetëm me një dëshirë: Të jetë fëmija i saj i gjallë...*

Në Fushë-Krujë, para njëmbëdhjetë vjetësh, në kohën kur ishte dhjetë vjeç, ishte zhdukur fëmija i një familjeje. Dhe, që nga atëherë nëna e tij bie dhe zgjohej nën ankth: Vetëm të jetë djali i gjallë! Kjo është sfida e një nëne, e cila, pas më shumë se dhjetë vjetësh, ka kuptuar se djali i saj është gjallë dhe jeton në shtetin Virgjinia të SHBA-ve. Por, ajo e di se është e huaja për fëmijën e vet biologjik, sepse atje shteti nuk e lejon kjo të nuhasë me shqisën e nënës...

## SI ËSHTË ZHDUKUR FËMIJA PARA DHJETË VJETËSH DHE SI KA ARRITUR NË SHBA?

Si është trafikuar dhe si ka rrjedhur trafiki? Si ka kaluar dete e oqeanë, për t'u bërë fëmijë i dikujt tjetër?

Para se të dalim te tema e dhimbjes, është edhe diçka me rëndësi: Në shqiptarinë tonë, dy gjëra nuk i kemi pasur kurrë adet: Të vjedhim fëmijë dhe t'i lëshojmë gratë! Nëna e djalit të humbur shpalosë detaje nga koha kur fëmija ishte vetëm dhjetë vjeç, e humbi pa gjurmë, sikur e lëshoi toka...

Dhe, nga ajo kohë, nëna e tij lutet të jetë i gjallë. Bie e zgjohet me lutje, duke e parë në ëndërr të birin e saj në njëqind mënyra... Shtrohet pyetja: Si mund të jetojë një nënë, duke rënë e zgjuar në ankth për djalin e humbur dhe duke pritur lajme 24 orë?

E, nëse e vërteta del në dritë, si do të paguhen lotët e saj? Kush i ka borxh asaj për të gjithë ngjarjet dhjetëvjeçare prejse i humbi i biri? Por, sikur të ishte vetëm një fëmijë i humbur?!

Ditë më parë ka humbur edhe një fëmijë në Suharekë dhe nuk dihet ku është...

## AH, PO TË MUND TA KTHEJA KOHËN E ENVERIT!

Në një ndejë të zakonshme të shtunën që e lamë pas, teksa përcillnim emisionin "Njerëz të humbur", njëri prej nesh tha: "Ah, po të mund ta ktheja kohën e Enverit!". Dhe, spontanisht i duartrokitem... Sepse, aty ku lëndohet ndjenja prindërore, thahet zemra! Aty ku preket ndjenja prindërore, këputet shpirti! Aty ku ndodhin lëndimet prindërore, nevojitet litari i varjes! A jemi bërë të pashpirt që rrëmbejmë fëmijë për tregti?! Dhe, shumë pyetje të tjera, që janë për keqardhje...

S. Murturi



# Gashi GmbH

## Malermeisterbetrieb

- Maler - Lackiererarbeiten
- Tapezierarbeiten
- Innen - Aussenputz
- Vollwärmeschutz
- Gerüst - u. Trockenbau
- Altbausanierung



GIEZUAR  
2024

Telefon: 0 67 31 / 450 05 / Telefax: 0 67 31 - 549 934  
55232 Alzey-Weinheim / Fasanenweg 4  
Internet: [www.gashi-alzey.de](http://www.gashi-alzey.de) / Email: [info@gashi-alzey.de](mailto:info@gashi-alzey.de)



# Të tana t' mirat e Zotit, e stresi i mbyti!

*Udhëtimin tonë nëpër të këqija e ngarkon edhe një e keqe, stresi. E, ndoshta, nuk kanë faj, sepse bukë kanë boll, vetura luksoze, shëtitje nga një vend në tjetrin. E, çka jo tjetër?!*

Shkojnë baba dhe nëna në Gjermani te i biri. Plaku 80 vjeç, gruaja 78 vjeçe. Me të shkuar te djali, shokët e miqtë e tij nisën t'i vizitonin mysafirët nga Kosova, plakun dhe plakën. Shkon shoku i parë i djalit dhe, sikur është rendi, fillon biseda me përshëndetje. "Si jeni me familje?", pyet plaku shokun e djalit. "Mirë, por na mbyti stresi. Që në mëngjes më ka thirrur shefi në telefon... Më tha: "Eja në punë se jam stresuar! Ta kryejmë sot punën e nisur dje se po më streson!".

## MË KA MARRË MALLI PËR PLAK ME PLIS...

Vjen në banesë një mysafir tjetër i djalit, për t'i vizituar prindërit e tij që kishin ardhur nga Kosova. "Si jeni axhok? A jeni mirë andej nga Kosova? Më ka marr malli të shoh plak me plis, se plisin e ka bartë babai im, ndjesë pastë. Jemi rritur në skamje, por edhe këtu nuk është jetë. Çfarë jete është kjo kur të del gjumi në orën 3 para mëngjesit e nuk mund të flesh nga stresi?! Po, si jetoni ju, atje, në Kosovë? Andej, shyqyr Zotit, nuk keni stres, e nuk dini çka është... Ju, atje, nuk stresoheni, me siguri, se jeta nuk është si këtu dinamike?! "Jo", i thotë plaku. "Shyqyr, mirë jemi. Nuk ka ardhur te ne ende ajo sëmundje... Po, prej cilit vend në Kosovë je ti, o burrë?!", ia kthen plaku. "Jam i Prelezit, afër Ferizajt, por qe tridhjetë vjet jam këtu, në shtet të huaj". "Prelezin e di ku është, por askënd nuk e njoh nga ai fshat", ia kthen ai. Vjen tjetri, pas një kohe. E, edhe ai po të njëjtat fjalë: "Mbaruam, mos pyet, jemi të gjithë të sëmurë në këtë vend të mallkuar!

Këtu mos kërkoni njeri të shëndoshë se nuk ka. Të gjithë jemi për spital. Stresi na mbyti. Edhe mua më ka përfshi, nuk ka vend që nuk më dhemb. Këtu është vend në të cilin askush nuk flet tjetër pos për punë. Këtu nuk i dinë këngët për Mujin e Halilin, këngët që i këndonim pasdarke kur shkonim te njëri-tjetri. Këtu është moza më keq! E, veç ne shqiptarët e kemi kaluar jetën këtu... Nesër, axhok, ti mbetesh vetëm, se këtu shkojnë në punë të gjithë. Ti mbetesh vetëm me kamish e duhan". Dhe, të nesërmen ndodhi ashtu, si i tha ai një natë më parë. Andaj, plaku i tha plakës: "Sa të vijë djali ka me na qu në aeroport dhe do të kthehemi menjëherë në shtëpi!". "Pse? A je në vete? Dje kemi ardhur e nesër të ikim?! Marre prej djalit të kthehemi menjëherë...", i thotë plaku. "Të ikim sa nuk na ka zënë sëmundja që e paskan këta. Këtu qenka njëfarë sëmundje që po i thoshin stres dhe krejt po i mbyste me rend! Cilido që qe mbrëmë ishte i sëmurë nga stresi. Prandaj, të ikim, plakë, më mirë në vendin tonë, se atje ende nuk ka ardhur ajo sëmundje..."

S. Murturi



# Gruaja po më vonohet nga puna!

Jam një burrë, nga Gjilani. Jemi familje me traditë. Jam 51-vjeçar, i martuar. Bashkëshortja ime punon, por vonohet nga puna dhe çdo ditë bëjmë zhurmë në shtëpi. Kur e pyes ku je që u vonove, zakonisht, thotë se me shoqe pi kafe pas punës. Jam i prirë t'i besoj, por ky besim imi po e brengosë familjen time... Redaksi e nderuar, çka të bëj, ju lutem?

Asimi, Gjilan

***Nuk do ishte keq ta presësh gruan afër vendit të punës dhe ta marrësh në shtëpi, sepse ashtu do ia lehtësosh edhe udhëtimin. Nuk është keq ta pyesni se në cilin lokal rri pas orarit të punës, aq më shumë kur në shtëpi ta pëshpëritin apo edhe ta thonë ashiqare se gruaja po të vonohet... Prandaj, duhet ta gjesh arsyen e kësaj vonese, sepse je burri i zonjës që vonohet dhe nuk duhet ta tolerosh që i njëjti avaz të përsëritet çdo ditë...***

# Pse vetëm për vajza të bukura ka punë?

*“Është e vërtetë se Kosova ka vajza të bukura, ndoshta si askund tjetër në shtetet e Evropës. E, nëse je e bukur dhe joshëse, ka shanse të të hapen dyert!”, kështu thotë Venita, 26 vjeçe, nga Prizreni.*

“Shpeshherë e falënderoj me zemër Zotin që ma ka falur bukurinë, sepse bukuria sot t’i hapë dyert. Vetëm nëse je e bukur mund të gjesh vend pune. E, nëse nuk je tërheqëse, e pat puna jote, ngele në mëshirë të fatit...

Por, s’kam arsye të gënjej, në punë jam e privilegjuar pse jam e bukur. Thënë të drejtën, edhe unë e kam gjetur ilačin që të dukem sa më bukur. E, ajo është veshja ime provokuese dhe dallohem nga të tjerat në firmën tonë”, tha Venita në vazhdim të bisedës sonë.

## **SHEFI FILLOI T’I HAPË “LETRAT”...**

“Qëkur fillova punën si menaxhere puna më eci dhe vazhdon të më ecë mbarë. Shpejt u ambientova. Përkrahja e shefit asnjëherë nuk më mungonte... Por, s’shkoj shumë kohë e shefi filloi t’i hapë “letrat”. Mirëpo, një gjë e tillë nuk më befasoj, se që nga dita e parë më shikonte me një sy ndryshe... Andaj, që të mos dorëzohesha, nisa

të përkushtohem edhe më shumë në punë...

E, kjo gjë e nevríkoste shefin tim, i cili më shumë kishte dëshirë që unë të dështoj në punë e të dorëzohem para tij, sesa punët të më ecnin për mrekulli, ashtu siç ndodhte realisht. Por, për çudi, pas shumë e shumë insistimesh që të më bënte për vete, kur pa se unë isha e përkushtuar vetëm për punë, më bëri kryeshefe të firmës dhe sot e atë ditë firma jonë i ka punët më mirë se çdo firmë tjetër në Prizren, ndoshta edhe në qytete të tjera të Kosovës.

Andaj, m’u për këtë, në listën e pagave të firmës sonë unë qëndroj pothuajse baras me shefin tim”, tha në fund të bisedës sonë Venita, e cila edhe një herë e falënderon Zotin që ia ka dhënë bukurinë dhe mençurinë.

**Diturie Haxhaj**





2024

GËZUAR FESTAT E FUNDVITIT

 Lanaderm

# “Murricën” e xha Sylushit e milnin duke i rënë defit!

*Bora e parë e këtij fundviti më ktheu në kohën e fëmijërisë, kohë kur xha Sylushi e pat blerë një lopë, por nuk linte ta milnin pa i rënë dikush defit te koka e saj...*

Isha aq i rritur sa të mbaja mend çdo detaj jete që vinte në atë dimër. Kisha filluar ta pëlqeja gjuhën e gjahtarëve në odën e babait, ku e tërë lagjja i bënte dasmat dhe aktet e mbarimit dhe pleqërimin të konflikteve.

Isha ulur mbi trapazanin mbushur me dru për stufën e madhe të odës, kur në derë u fut xha Sylushi.

Me të ulur në shilte, hoqi mahramën që ia kishte përdredhur stuhia e fortë dhe e shtriu rreth plisit në kokë.

“Për hajër lopa që e kishe ble!”, i thanë burrat në odë.

“Hajër paçi! E mirë po doket, se lopët e zeza e kanë tamblin më të trashë!”, ua ktheu ai.

“Prej kah ish kanë i zoti i saj?”, e pyeti xha Raifi.

“Ish kanë nga një katund ndërmjet Malishevës e Rahovecit. Mezi ia mora,

sepse kishte shumë myshteri. Por, edhe pse lopë e mirë, e kish një behane: Nuk po le me e mjelë e na mbyti me shqelma!”, i tha ai.

“Hajër koftë! Ktheja mbasi paska behane!”, i tha xha Raifi.

“Jo more, si kthehet lopa vetëm pse nuk le me e mjelë?! Është përhujsëm!

Bile, do lopë edhe e humbin tamlin kur e ndërrojnë vendin...”, ndërhyri Ejupi, burrë me moshë mesatare.

Dhe, në çast, ndërroi muhabeti në odë...

## **BJERI DEFIT**

### **TE KOKA E “MURRICËS”!**

U fejua djali i xha Sylushit me Hanifen e katundit tonë. Para orës 12 u bënë gati petullat, se dora e nuses duhej të jepej para asaj ore.

E, me dëshirën e familjarëve, festa do të vazhdonte edhe në darkë, meqë kishin qëlluar shumë kurbetçarë në pushim, e pas darke luanin lojën e kapuçave...

Dhe, në kohën kur ishte koha e mjeljes së “Murricës”, vajzat ishin në kulm të gazmendit me defe.

S’di si e sajuan vajzat këngën në shpejtësi, por “Murrica” më nuk hodhi shqelma dhe nuk e derdhi qumështin:

“Kemi zënë nuse

Shumë jemi gëzu,

I kënojmë kangë nuses

I kënojmë kangë “Murricës”

S’ka me gju më shkelma!”.

Dhe, ditë pas ditësh u përhap lajmi në lagje se “Murrica” nuk lë me e mjelë pa i rënë defit te koka e saj...

**S. Murturi**






# A&M

## MEGA STORE

Nga zemra falenderojmë çdo klient për vizitat e shumta në Ferizaj, Mitrovicë, Pejë, Podujevë, Prizren, në Prishtinë tek qafa, në Fushë Kosovë si dhe në dyqanin më të ri në magjistralen Prishtinë/Ferizaj!

Faleminderit për momentet fantastike që na i dhuroat në vitin **2023!**

Urojmë që viti **2024** të jetë një vit me plot hare dhe gëzime në familjen tuaj!  
Gëzuar!



Po shuhen dalëngadalë...

# S'po i bie më çobani fyellit!

*Derisa endesha nëpër treg në Ferizaj, shikoja mallrat që kanë vërshuar kryesisht nga Turqia dhe Kina dhe më bëhej se ndodhem në një botë të huaj, në mes të Stambollit, në mesin e njerëzve të huaj.*

*Por, rastisa në një shitës të fyejve!*

*Dhe, e ndjeva veten se jam në tokën time...*

Si malësor, nga Jezerci, u rrita me fyell e çifteli.

Por, me kohë, e sidomos pas lufte, u lanë e u harruan fyelli e çiftelia, kavalli e lahuta...

"Dikur çiftelia e sharkia në anën tonë mbaronte Beqir Prelezi. Ai edhe u binte si askush tjetër.

Por, ai ka vjet që më nuk është dhe tash vetëm Fatmir Makolli i afrohet me shkathësitë dhe aftësitë e tij në interpretimin me çifteli", thotë Dan Sojeva, 73 vjeç, nga Ferizaj, i cili më shoqëroi teksa i shikoja fyejt.

Tash vetëm surlat e tupanët mbetën në dasma, syneti si në filmat turq, e ahengje të ndryshme familjare, sa për biznes, sepse vetëm muzikën tallave po e ha pazari...

E, sa ishin instrumentet burimore ishin edhe mjeshtrit e tyre, ata që i mbaronin dhe ata që loznin me to, talentet e ekzekutimit.

Një i tillë, e që ishte i pashoq në ekzekutimin e fyellit e kavallit, ishte Shaqir



Ilustrim: I pazëvendësueshmi Shaqir Hoti

Hoti, por edhe ai shkoi...

Megjithatë, këtu, në Ferizaj, në qosh të pazarit, njëri shiste fyej, të cilët i kishte renditur në një kuti letre dhe priste blerës, adhurues të fyellit.

## S'HA MË KUSH ME LUGË DRURI!

Dhe, tekta largohem nga shitësi i fyejve, një mesoburrë shet lugë të punuara prej druri.

Bëhem kureshtar dhe i afrohem.

"Nga je?", i them.

"Nga Zaskoku", më thotë.

"A i punon lugët vetë apo i ke marrë nga tjetër kush?"

"I punoj vetë. Dhe, me këtë zanat merrem qe 40 vjet".

"Prej cilit lloj druri i bën lugët?"

"Lugët më së miri punohen nga fra-shri i thatë, kurse tëhollueset i punoj nga ahu. Edhe për lugët, e edhe për tëhollueset druri duhet të qëndrojnë në vend të terur një vit që të thahet".

"The se qe dyzet vjet merresh me këtë

zanat, a?"

"Po, qe 40 vjet e punoj këtë zanat. Por, me shitjen e lugëve dhe tëholluseve merrem qëkur isha 15 vjeç. Në atë kohë babai, rahmet pastë, i punonte e unë i shisja në treg.

Tash shitja e lugëve ka rënë shumë. Vetëm tëhollueset shiten më shumë, sepse u nevojiten grave për përgatitjen e petëve.

Lugët prej druri më shumë i blejnë bashkatdhetarët tanë për kujtim, që ua kujton një kohë të shkuar. Sepse, tash pakkush ha me lugë druri, ani pse luga prej druri është shumë më e shëndetshme dhe e ruan shijen e ushqimit.

Sidoqoftë, dikur kam punuar edhe vegla të tjera prej druri, e që nevojiteshin për bujqësi, por teknologjia i hoqi nga përdorimi!"

Dhe, tekta largohem nga ai, në shenjë kujtimi ma dha një lugë prej druri, të cilën ia dhashë gruas që të shërbehet me të në kuzhinë.

S. Maloku





URIME

*Viti i Ri*

**2024**

NGA

**KENDA**  
CENTER  
BY SHKENDA DUBOVA  
[www.kendacenter.com](http://www.kendacenter.com)

# Cili gjerman i ka zbuluar 1001 fshehtësi për Kosovën?

*Hansi, 65 vjeç, nga një fshati i Munihut të Gjermanisë, në Kosovë vjen çdo verë. Në Kosovë thotë se i qetësohet zemra. Pse?*

Hansi i Munihut të Gjermanisë vjen çdo verë në Kosovë, te shoku i tij në Gadime të Lipjanit, me të cilin jeton në fqinjësi në Gjermani. Ai një muaj të çdo viti e kalon në Kosovë.

Ka mësuar aq shumë gjëra për Kosovën sa shumëkujt i mban ligjëratat për këtë vend.

E takova Hansin gjatë verës teksa bëhej gati të nisej për në Bogë të Rugovës. "Eja me mua!", më thotë, teksa hapë derën e xhipit "Volvo", i bardhë si bora. Dhe, kur hipa në të, në kabinën e xhipit temperatura shënonte 30 gradë. E, pas dy orë ecje me veturë, jemi në Bogë...

Kur arritëm te krojet e Sali Ramës të

kapë të ftohtit. Ende pemët ishin në lule, e që në rrafshin e Kosovës një gjë e tillë ishte moti, sepse temperatura në Rugovë është për nja 15 gradë më ftohtë.

Madje, edhe me Amerikën e kemi më afër me temperaturë sesa Rugovën e Bjeshkët e Nemuna!

Pra, në një vend kaq të vogël, në Kosovë, ka dallime shumë të mëdha në temperaturë, madje edhe në brendi të saj, meqë Gjakova, Prizreni, Rahoveci e Suhareka janë më të nxehta se Prishtina, Mitrovica, Ferizaj e Gjilani.

"E, pse ndodh kjo?", më pyet Hansi. Sepse, rrafshi i Kosovës dikur ka qenë një liqe i madh dhe mu ai rrafsh është shndërruar në hambar buke për Kosovën. E drithërave u duhet nxehtësi që të piqen me kohë...

## DREQËRIT GJUAJNË ME GURË NË MALISHEVË!

Në Pagarushë të Malishevës para do vjetësh ka ndodhur diçka spektako-

lare. Dikush ka gjuajtur me gurë mbi çatitë e mëhallës dhe njerëzit janë detyruar të ikin nga shtëpitë e veta... "A mos kanë qenë serbët?!", më thotë Hansi.

"Jo, o mik, serbët kanë ikur më 1999. Por, kanë qenë naletët! E, naletët janë qenie që dalin dhe veprojnë natën dhe nuk shihen nga syri i njeriut! Janë qenie që e trazojnë gjithë mëhallën! I përplasnin lugët dhe pirunët nëpër shtëpi, i përplasnin tenxheret e tepsitë! Krijojnë zhurmë në çdo shtëpi...".

Hansi, në çast, ndalet dhe shikon rreth vetes nëse e ka ndonjë nalet afër...

"Nuk ka afër teje naletë, o Hans, sepse naletët nuk rrinë afër gjermanëve, por jetojnë vetëm me shqiptarë!

Sepse, në Kosovë të gjithë janë të dijshtëm! Të gjithë japin këshilla!". Dhe, që t'i vëmë kapak këtij muhabeti, i them Hansit të ulemi në restorantin e parë që hasim, të pimë nga një kafe rehat e të mos merremi me naletë..

**S. Krivaça**



A woman with long dark hair and a young girl wearing a Santa hat are looking at a gift. The woman is smiling and looking down at the gift. The girl is also smiling and looking at the gift. The background is dark with warm lights and a string of lights. There are green pine branches in the corners.

2024  
Gëzuar

**CIMA**  
Construction

*Unë, mërgimtari...*

# Si e mashtrova gruan e martuar?

*Njohja jonë ndodhi në komunë, menjëherë pas lufte, teksa prisnim t'i dorëzonim dokumentet e udhëtimit. I thashë se kisha ardhur për pushim nga Anglia, se isha i pamartuar. E, ajo më besoi...*

E vetmja dëshirë imja asaj vere të dytë pas lufte ishte të rregulloja dokumentin e udhëtimit, sepse ai që e kisha nga regjimi serb i kishte kaluar afati. Dhe, në atë tollovi të padurueshme në korridorin e komunës, pranë meje priste një femër e bukur, rreth 35 vjeçe, veshur hollë e bukur. Më tha se e kishte burrin në Gjermani, por që ende nuk e kishte rregulluar leje qëndrimin, që ta merrte me vete. I thashë unë kam leje qëndrimi në Angli dhe mund ta ndihmoja që të shkonte në Gjermani... Madje, kur i thashë se nuk jam as i martuar, iu bë qejfi dhe gati sa nuk më puthi në mesin e gjithë asaj turme... Dhe, biseda jonë u zgjerua duke kritikuar punën e ngathtë të komunarëve,

të cilët tërë ditën na lanë duke pritur në rend, që të afroshim te sporteli...

## **DOLËM PËR NJË KAFE E PËRFUNDUAM NË BANESË!**

Atë ditë, pasi i dorëzuam dokumentet, meqë unë isha para saj, e prita tek kreu punë. I thashë: "Një kafe do na i qetësonte nervat!". Ma ktheu: "Mirë do ishte!". Dhe, mu këto fjalë bën që ne të ndalemi në kafenenë përballë komunës, që vetëm rruga ndodhej ndërmjet. E, ajo që më la mbresë të jashtëzakonshme ishte përshtypja se si ajo, pa më njohur fare, nisi t'më tregonte për jetën e saj, martesën para 10 vjetësh, shkuarjen e burrit të saj në Gjermani

dhe komunikimi i tyre vetëm nëpërmjet telefonit...

Dhe, kur mendova se është koha të ngrihem, më tha: "Shkojmë në banesën time për nga një gotë verë!". U hutova... I pohova me kokë – po.

## **MOS U MARTO ME MUA, VETËM MË MERR ME VETE!**

E, kur hymë në banesën e saj, teksa i solli gotat me verë, më tha: "Ti vetëm më merr me vete e me u martua me mua s'ke nevojë!". Por, në vend të përgjigjes, iu afro afër, e rroka për beli dhe e shtrëngova për trupin tim. Buzët e saj zjarr ma turbulluan mendjen dhe i thashë "po".

**E, Emini, Angli**





# DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE

# 4 shenjat që do të kenë më shumë fat në dashuri në 2024

*Cilat janë 4 shenjat që do të jenë më me fat në dashuri gjatë vitit 2024? Mësoni në vazhdim...*

## **BINJAKËT**

Binjakët janë më të favorizuarit. Fati është në anën tuaj dhe do të bëheni të kërkuar me shkëndijën, sharmin dhe stilin tuaj pa kompleks.

Klubi juaj i fansave do të rritet edhe më shumë, pasi popullariteti juaj do të rritet dhe ka shumë mundësi që një lidhje e re të lulëzojë.

Nga ana tjetër, nëse tashmë jeni të përkushtuar, do ta prisni me shumë optimizëm vitin që po vjen, meqë gjërat do të shkojnë kah më e mira dhe ka mundësi që në këtë periudhë të merret vendimi për martesë apo për të jetuar bashkë.

## **LUANI**

Me ditët e para të vitit të ardhshëm, fillon një periudhë në marrëdhëniet tuaja të dashurisë, ku do të keni atë që pëlqeni. E, çfarë duhet të bëni ju?

Rifitoni vitalitetin dhe humorin tuaj të gjallë, harroni protokollet, arrogancën dhe

stilin e deritashëm.

Ndjenja e aventurës së kombinuar me erotizmin dhe mungesën e plotë të interesit për atë që do të ndodhë nesër, janë garancitë tuaja për sukses me seksin e kundërt, ndaj mundësia për një romancë freskuese është shumë e mundshme.

E, nëse jeni në lidhje, do të kënaqeni me kohën krijuese që kaloni me partnerin, ndërsa nëse keni fëmijë do ndiheni të kënaqur nëpër momentet që do të ndani.

## **DEMI**

Në vitin e ardhshëm, përveç faktit se financiarisht situata juaj do të fillojë të përmirësohet, pasi paratë do t'u vijnë në dorë, të cilat do t'u lejojnë të mbulonin nevojat tuaja fikse dhe të shpenzoni për të kaluar sa më mirë, libidoja juaj do të godasë dhe do të tërhiqeni si magnet...

Sfidat, tundimet, netët e nxehta të dashurisë dhe realizimi i dëshirave seksuale do t'u largojnë në një mënyrë reale, emocionuese, ndërsa është e mundur të

“lidheni” me një person që do t'u tregojë anën më të lehtë të jetës.

Qofshi beqar apo në lidhje, viti që po vjen për ju është periudhë shumë romantike dhe lozonjare, e gjithçka që duhet të bëni është ta shijoni...

## **AKREPI**


Viti i ardhshëm për ju në dashuri do u japë të gjitha mundësitë, në mënyrë që të merrni gjithçka që dëshironi, materialisht dhe në aspektin romantik.

Sikur të keni një lloj magneti në duar, do të tërhiqni paratë, ndërkohë që është e mundur, nëse punoni me zgjuarsi dhe fleksibilitet, të bëni një marrëveshje shumë të mirë.

Nga ana tjetër, ju jep optimizëm, argëtim dhe energji për argëtim edhe më të madh...

Në të njëjtën kohë do të rindizet edhe interesi juaj seksual për partnerin, ndaj priten edhe momente të shkëlqyera.





*Granit Xhaka*

*Taulant Xhaka*

## MAGJISTARJA

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

*kontaktoni në këtë email adresë:*

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)

### Jam mirë, por jo bash mirë! Pse?

Jam nënë, 55 vjeçe. I kam dy fëmijë (22 dhe 20 vjeç), jetoj në Amerikë. Kam një shqetësim të përditshëm, sepse më dhemb çdo ditë diku. Kur shkoj te mjeku më thotë se nuk kam asgjë... Kam bërë analiza, por nuk hetohet ndonjë problem. Pse e kam këtë problem, motër e nderuar?

**"Amerika"**

### Përgjigje:

*Ti, në fakt, nuk e ke këtë problem nga sot e as prej dje, por kështu ke jetuar që nga koha kur je martuar. De fakto, nuk je paciente, por nuk je edhe larg pacientes. Nuk ke asnjë problem, por ke dhimbje që shkaktohen nga baza nervore psikiatrike, e që rrjedh nga e kaluara traumatike. Traumatizmi nuk shërohet lehtë. Breza të tërë njerëzish jetojnë me trauma dhe kanë nevojë t'i shërojnë traumat. Në rastin tënd nuk bën punë mjekësia e as jeta klinike,*

*sepse kur je mirë me rezultate mjeko-laboratorike, barërat përjashtohen si zgjidhje.*

*Lufta të mbetet ty, prandaj edhe ka shërim alternativ...*

### A ta lypim vajzën e mikut për djalë?

Përrshëndetje zonja magjistare! Jam nënë e dy fëmijëve. Jetoj në Zvicër. E kam djalin e madh për martesë dhe jemi bërë merak ta lypim vajzën e mikut për djalë.

Por, punët nuk po ecin si duhet...

A mos kemi gabuar që i kemi hyrë kësaj pune?

**"Nëna nga Zvicra"**

### Përgjigje:

*Zakonisht, kur miqësia do që ajo të trashet më tej, ai që në këtë rast bën propozim është pala e familjes që e ka vajzën. Në rastin tuaj, familja e mikut do të duhej ta hapte këtë temë e jo ju. Sepse, vetëm në këtë mënyrë do të vazhdonte miqësia me trendin e vjetër mes jush. Por,*

*kur familja e djalit e kërkon vajzën e mikut, gjërat mund të mos shkojnë më si dikur... Megjithatë, shoh se do të plotësohet dëshira juaj, sado që gjërat po lëvizin me zor.*

### Pse nuk po më ec puna?

Përrshëndetje, jam A. K., e lindur më 1999. Kam pasur gjithmonë ëndërr të kem punën time dhe të mos mbetëm amvise. Për këtë qëllim e kreu një kurs për frizere. Hapa lokalin tim, por nuk më shkon puna. Pse kam stagnuar dhe a do të kem punë?

**"Arbëresha"**

### Përgjigje:

*Para së gjithash, ti ke punuar në rrethin tënd dhe klientela është nisur nga parimi i thjeshtë se ti nuk i përmësh aspiratat e tyre.*

*E, rrethi ynë gjithnjë e preferon të huajin...*

*Reklama e propaganda, si dhe hapësira e mirë e punës e aparatura, sot janë pjesë të pandashme të suksesit, për çka ti nuk i ke në nivel të duhur. Këto gjëra bëjnë që të mos përfitosh aq sa duhet. Këshilla ime është: Vazhdo me këtë zanat, sepse do të kesh punë!*

### Më i madhi i shtëpisë po na i tollovitë punët!

Zonja magjistare, jam nga komuna e Prizrenit. Jemi familje e madhe. Por, ne, brezi i ri, duam të



jetojmë më ndryshe e të mos varemi nga komanda e një plaku! E kemi shtruar kërkesën për ndarje të pasurisë që kemi, por plaku nuk pranon ndarje.

A do të ndahemi, sepse nëna ime është sëmure nga puna e madhe, por as kunnatat e saj nuk qëndrojnë më mirë me shëndet?

**“Opoja”**

**Përgjigje:**

*Secila shtëpi, kishin thënë dikur, duhej ta ketë një të mençur dhe një budalla. Të mençurin do ta vënin në ballë të burrave, kur kërkohet të përfaqësohet familja për punë mençurie.*

*E, nëse i mençuri nuk kryen punë, atëherë do të dilte budallai ta bënte atë.*

*Pse?*

*Sepse, atij do ia lëshojnë rrugën, duke ia plotësuar kërkesat...*

*Te ju, mjerisht, të gjithë jeni të mençur, andaj sa të jeni të gjithë të mençur nuk do të ketë ndarje, por do të ketë vetëm komandë dhe urdhra, për çka do të vuajnë të tjerët.*

**E kam vëllanë agresiv!**

Përshëndetje motër magjistare! Jam një motër e shqetësuar me reagimet e vëllait, sepse është agresiv ndaj prindërve dhe është ndodhur para sulmit sa e sa herë për qëllimet e veta! E kanë lajmëruar në polici, por ai, duke u maskuar se

nuk i sulmon, është liruar dhe përsëri ka përdorur dhe po përdorë dhunë ndaj tyre.

Çka do të ndodhë me të?

**“Motra”**

**Përgjigje:**

*Mosedukimi i djalit me kohë ka prodhuar situatë shqetësuese në shtëpinë tuaj, për çka ai, i pakënaqur me kushtet që i ka ofruar familja, reagon duke kërkuar aq sa i duhet për harxhime.*

*Dhe, sa herë që prindërit nuk kanë mundësi t'i japin, ai i qorton dhe i sulmon pse ata nuk janë më të pasur! Kjo është, zakonisht, formula mbi të cilën ndodhin këto gjëra, por nuk janë të pakta sulmet e fëmijëve të rritur ndaj prindërve sot, raste me të cilat duhet të merret shteti.*

*Një hadith i pejgamberit a. s., thotë:*

*“Kush nuk e dëgjon nënën dhe babanë, e djegtë zjarri i ferrit!”*

*E, ai zjarr nuk i atribuohet vetëm botës së amshuar, por edhe kësaj bote në të cilën jetojmë, sepse askush nuk do të shkojë në botën tjetër pa i larë gjynahet këtu...*

**Ku e ka vajza fatin?**

E dashura magjistare, na ke ndihmuar dy herë, duke na i zgjidhur problemet. Kërkojmë përsëri të na hapni rrugë për fatin e vajzës së dytë, se ende nuk e ka

## PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

gjetur fatin e përjetshëm. Vajza ka qenë e martuar tri vjet dhe është ndarë...

A do të martohet përsëri dhe ku do ta ketë fatin e ri?

**“Nëna e mërztur”**

**Përgjigje:**

*Shoh se ajo do të martohet vitin që vjen, kah mesi i gushtit. Do ta gjejë fatin e ri në rrethinën tuaj, por jetë do të bëjë në Gjermani.*

**A do t'i mbijetojë nëna operacionit?**

Nënë e kemi të sëmure. Është 74-vjeçare dhe ka për t'iu nënshtruar një operacioni kundër kancerit. Jemi të brengosur se a do ta kalojë këtë operacion ajo...

**“Lutje për nënën”**

**Përgjigje:**

*Kur flitet për një sëmundje që dihet çka sjell, nuk mund të thuhet me saktësi se a do ta kalojë me sukses apo jo operacionin.*

*Por, ajo që duhet nënkuptuar është që të merret me qetësi çdo gjendje që sjell Zoti i madhërishëm.*

*Shoh se nëna juaj do ta kalojë fazën operative.*

*Por, sa do të arrijë, pastaj, të shërohet, kjo është çështje që e di vetëm i lumi Zot...*



**SHERWOOD**  
*Resorts and Hotels*



**GREENWOOD**  
*Resorts and Hotels*

# Gezuar Vitin e Ri 2024

Qoftë 2024 një vit i mbarë për  
ëndrrat dhe shpresat e  
gjithësecilit prej jush!

[www.sherwoodhotels.com.tr](http://www.sherwoodhotels.com.tr) | [www.greenwoodhotels.com.tr](http://www.greenwoodhotels.com.tr)